



# **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“Mbi auditimin e përputhshmërisë në detyrimet e ndërsjella në KESH, OSHEE, OST”**

**Tiranë, shkurt 2025**

|            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |     |
|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
|            | Përmbajtja                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 1-2 |
| <b>I</b>   | <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 3   |
|            | a) Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit<br>b) Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve<br>c) Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit                                                                                                                                                  |     |
|            | 1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit                                                                                                                                                                                                                                                                           | 8   |
| <b>II</b>  | <b>HYRJE</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 9   |
|            | 1. Objektivat dhe qëllimi<br>2. Identifikimi i çështjes<br>3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese<br>4. Përgjegjësitë e audituesve<br>5. Kriteret e vlerësimit<br>6. Standardet e auditimit<br>7. Metodot e auditimit<br>8. Dokumentimi i auditimit                                                             |     |
| <b>III</b> | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 12  |
| 1          | Informacioni i përgjithshëm mbi subjektet nën auditim                                                                                                                                                                                                                                                             | 12  |
| 2          | Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit                                                                                                                                                                                                                                                              | 13  |
| 2.1        | Paraqitja dhe evidentimi i detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare, dakordësitë dhe pretendimet përkatëse mes shoqërive publike në sistemin energjitik.                                                                                                                                                   | 13  |
| 2.2        | Procedurat, masat e marra nga organet drejtuese dhe grupet e ngritura të shoqërive publike në sistemin energjitik për zbatimin e parimeve udhëzuese të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, VKM-ve, urdhrave dhe marrëveshjeve përkatëse në lidhje me detyrimet e ndërsjella.                                      | 19  |
| 2.3        | Vlerësimi i situatës debitore në tërësi, zbatimi i masave të marra për evidentimin, adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe efektet e krijuara nga mos realizimi i objektivave të përcaktuara. | 39  |
| 2.4        | Të ndryshme të dala gjatë auditimit                                                                                                                                                                                                                                                                               | 44  |
| <b>IV.</b> | <b>REKOMANDIME</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 51  |

## **I-PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Subjektet që përfshihen në këtë auditim janë:

1. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.
2. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
3. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Sistemi energjitik në Shqipëri përbëhet aktualisht nga tre shoqëri publike: KESH, OST dhe OSHEE, të ndara për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen dhe që e kanë zanafillën në KESH, e cila i përmbledhë më parë të tre këto aktivitete. KESH ka nën administrim impiantet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend. OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispecerimit dhe Operatorit të Tregut. OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes (OSHEE), konsumatorëve të energjisë elektrike, transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit, si dhe për transitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit. OSHEE është licencuar për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

### **Auditimi do të fokusohet si vijon më poshtë:**

-Paraqitjen dhe evidentimin e detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare, dakordësitë dhe pretendimet përkatëse mes shoqërive publike në sistemin energjitik.

-Procedurat, masat e marra nga organet drejtuese dhe grupet e ngritura të shoqërive publike në sistemin energjitik për zbatimin e parimeve udhëzuese të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, VKM-ve, urdhrave dhe marrëveshjeve përkatëse në lidhje me detyrimet e ndërsjella.

-Vlerësimi i situatës debitore në tërësi, zbatimi i masave të marra për evidentimin, adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe efektet e krijuara nga mosrealizimi i objektivave të përcaktuara.

Aftësia paguese e sektorit shqiptar të energjisë elektrike është një problem shumë i rëndësishëm i sektorit. Në pjesën më të madhe kjo është pasojë e performancës së Shoqërisë së Shpërndarjes OSHEE, pasi ka humbje të mëdha teknike dhe joteknike në sektorin e shpërndarjes dhe mbledhje të pamjaftueshme të parave nga faturat e klientëve. Në parim, ky problem mund të trajtohet nga injektimet të rëndësishme financiare nga qeveria, nga politika dhe reforma të tjera për të përmirësuar performancën financiare të njësive të sektorit ose, në rastin më të mirë, nga një kombinim i këtyre dy qasjeve. Duke pasur parasysh se financat e qeverisë janë të kufizuara dhe do të nevojiten reforma të politikave për të mundësuar çdo injektim financiar, në mënyrë që injektimet të tilla të mos kërkojnë rregullisht, fokusi duhet të jetë në iniciativat që mund të përmirësojnë performancën financiare nëpërmjet iniciativave në sektorë që nuk kërkojnë fonde nga qeveria apo pritshmëri të ndonjë financimi tjetër të jashtëm.

Ky auditim përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, politikave të ndjekura, masave të marra nga shoqëritë, marrëdhëniet për borxhet e ndërmjetme dhe, me sa vijon:

-Nëse pasqyrat financiare, detyrimet mes palëve janë të dakordësuara;

-Nëse kushtet e marrëveshjeve për pagesat mes palëve janë zbatuar;

-Grupi i Auditimit ka kryer procedura për të përcaktuar, nëse ato ekzistojnë ose janë përdorur për qëllimet e tyre të synuara në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse dhe, nëse procedurat

e kontrollit ekzistojnë dhe janë vendosur në veprim për t'i mbrojtur ato në mënyrë adekuate. Si pjesë e procedurave për të përcaktuar nëse ato janë përdorur për qëllimet e synuara, audituesit kanë kryer rishikime të përdorimit përfundimtar për një mostër të përshtatshme të të gjithë zërave bazuar në vlerësimin e rrezikut të kontrollit. Rishikimet e përdorimit përfundimtar përfshijnë vizita në terren për verifikimin e ekzistencës së tyre ose përdorimin e tyre për qëllimet e tyre të synuara në përputhje me objektivat e projektit.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucionet për periudhën nën auditim në lidhje me transaksionet e kryera kanë dokumentet justifikuese dhe mbështetëse.

#### **b. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

Në procesin e verifikimit të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare të shoqërive OSHEE, KESH dhe OST u konstatua mosaprovimi i pasqyrave financiare në afatet ligjore nga Këshillat Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, të shoqërive OSHEE dhe KESH, gjë e cila vështirëson procesin e konsolidimit të detyrimeve.

-Në marrëdhëniet mes palëve, përfaqësuesit juridikë të shoqërive nuk kanë kryer verifikime e vlerësime të detyrimeve të ndërsjella pas vitit 2021, për shqyrtimin e situatës dhe marrjen e masave korigjuese. OSHEE me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.2 miliardë lekë. Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore të ndarjes shoqërive në vitin dhe penalitete të ndryshme midis palëve. OST me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 1.5 miliardë lekë. Kjo diferencë përbëhet nga faturat të papranuara nga OST, që janë penalitete për moslikujtime në afat, të energjisë elektrike të ofruar për disbalancat, aktivizim rezerve dhe shërbime të tjera. OSHEE me OST, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.3 miliardë lekë, e cila përbëhet nga faturime të OST-së ndaj OSHEE-ë në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, vlerë e ankimuar në gjykatë. Mosdakordësitë që shoqëritë e sistemit energjitik kanë mes tyre për llogaritë përkatëse debitore pengojnë procesin e konsolidimit të detyrimeve të mbartura dhe kompensimin/shuarjen e tyre.

-Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes disa marrëveshjeve ristrukturimi afatgjatë mes kompanive.

Nga grupi i auditimit u konstatua se OSSHE Group sh.a. e cila ka barrën e pagesave ndaj KESH-it sh.a. dhe OST sh.a., nuk ka bërë një plan pagesash (skedul) për ndarjen me këste të detyrimeve që kompanitë bija OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. do duhet të ja paguajnë duke mundësuar dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a..

Mospasja e një marrëveshje për ndarjen me këste të detyrimit respektive që secila kompani ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. ka sjellë edhe mospagesën e këtyre detyrimeve të plota dhe në kohë duke mos ju përmbajtur marrëveshjes që OSHEE Group ka me KESH sh.a. dhe OST sh.a.. Për marrëveshjet që OSHEE Group ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. pagesat janë kryer vetëm nga shoqëria OSSH sh.a. por edhe ato pagesa që janë bërë janë jo të plota dhe në mospërputhje me detyrimin që OSSH sh.a. ka.

- Për të përballuar gjendjen e vështirë financiare dhe një mungesë të theksuar likuiditetesh KESH i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbështetje buxhetore për veprimtarinë që kjo shoqëri ushtron me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbimin publik të ngarkuar. Kjo mbështetje e kërkuar është alokuar për shoqërinë

nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet një Huaje Buxhetore në vlerën totale 68 milionë euro, në vitin 2022.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, konkretisht neni 3, pika 3, në buxhetin e vitit 2022 është shtuar *“Fondi prej 20,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjitik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat.”*.

Kërkesave të KESH-it për pagesat e kësteve nga 2021-2023, OSHEE nuk i'u është përgjigjur dhe nuk ka paraqitur relacione për shkaqet e mos pagesave.

Mos plotësimi i detyrimeve nga ana e OSHEE për pjesën përkatëse ndaj KESH-it, si dhe situata emergjente ka detyruar Buxhetin e Shtetit të akordojë ndaj KESH kredinë 68 milionë euro si shtesë në kapital 20 miliardë lekë.

Nga të dhënat e marra nga buletinet e Ministrisë së Financave, kosto mesatare borxhit të brendshëm për vitet 2022-2024, nuk ka qenë asnjëherë më poshtë se 4 %.

Për sa më sipër, mos veprimet nga OSHEE për shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it, për periudhën 2022-2024, në pjesën e tyre kanë sjellë shpenzime interesi pa efikasitet nga Buxheti i Shtetit, në vlerën 635,196,774 lekë.

-Moskorrektësia e pagesave ndërmjet shoqërive në sistem ka sjellë akumulimin e penaliteteve e shoqëruar me faturat përkatëse, duke sjellë rritje të detyrimeve, mosmarrëveshje mes palëve dhe jodakordësi për situatën financiare dhe përkeqësim të saj jo të justifikuar.

-Detyrimet e akumuluar ndër vite në shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike, kanë ndikuar negativisht në të gjithë sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht në aktivitetin ekonomik të secilës shoqëri pjesëmarrëse në këtë sektor. Pasojat kanë qenë të shumta, si rritja e kostove të shërbimit, mungesë e realizimit të investimeve në nivelin e duhur, humbje në energji, uljen e aftësisë paguese të tyre, marrjen e huave për mbulimin e një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve, duke përkeqësuar kështu performancën e tyre.

Performanca e ulur e sistemit energjitik është e lidhur dhe me situata të tjera si emergjenca botërore e rritjes së çmimeve, kushtet klimaterike të thata, bëjnë që energjia të importohet me çmime më të larta se sa prodhimi në vend, duke ndikuar në rritjen e kostos së shërbimit gjë e cila reflektohet në shoqërinë KESH sh.a., e cila ka detyrimin për furnizimin e energjisë në sistem.

Si rezultat janë akumuluar detyrime të reja mes kompanive. Detyrimet e prapambetura nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujit, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura dhe parashikueshmëria e të ardhurave janë penguar, duke krijuar vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit në sektor. Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor. Përmirësimi i aftësisë paguese të sektorit të energjisë elektrike është një problem shumë i rëndësishëm.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore**

-Mosdakordësitë që shoqëritë e sistemit energjitik kanë mes tyre për llogaritë përkatëse pengojnë procesin e konsolidimit të detyrimeve të mbartura dhe shuarjen e tyre. Duke u nisur nga natyra komplekse e marrëdhënieve mes tyre, përfaqësuesit juridikë të shoqërive duhet të marrin masa për

zgjidhjen e mos marrëveshjeve në rrugë gjyqësore të përshpejtuara duke pasqyruar vendimin përfundimtar në pasqyrat financiare ose nëpërmjet miratimit/njohjes nga asambleja e ortakëve duke u ndodhur në rastin që është e njëjta për shoqëritë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

-Organet drejtuese të shoqërive OSHEE Group sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a., në lidhje me detyrimin që OSHEE Group sh.a. ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a., dhe që është i përcaktuar në pasqyrat financiare të shoqërive bija, duhet të dakordësojnë afatet e pagesave mujore ose tremujore në mënyrë që marrëveshja kryesore të zbatohet dhe situata debitoare të përmirësohet. Zvogëlimi llogarive kreditore të KESH sh.a. dhe OST sh.a., nga OSHEE Group sh.a. do të përmirësonte situatën respektive financiare dhe do të mundësonte investime të mëtejshme për të rritur performancën, likuidimin e detyrimeve përkatëse ndaj bankave në afat dhe shmangien e penaltiteve.

-Organet drejtuese të OSHEE, Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionareve të shqyrtojnë vlerën 635,196,774 lekë e cila përbën shpenzime pa efikasitet për Buxhetin e Shtetit dhe të marrin masa që në programin ekonomik të OSHEE të planifikohet dhe zbatohet likuidimi i kësteve të marrëveshjes që ka lidhur me KESH.

-Organet drejtuese të shoqërive të sistemit energjistik kanë të nevojshme të konsolidojnë pozicionet financiare për mos rakordimet mes palëve, të ndalojnë akumulimin të detyrimeve të ndërsjella bazuar në objektivitet dhe mirëkuptim.

-Organet drejtuese të OSHEE Group sh.a., FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. të marrin masa për krijimin e mekanizmave të monitorimit të performancës në sistemin e shpërndarjes dhe faturimit dhe mbledhjes së pagesave në sektorët problematikë (institucionet buxhetore dhe ujësjellësit), aplikimin e politikave të garancive dhe mekanizmave të brendshëm për të siguruar pagesën nga entet buxhetore të detyrimeve për furnizim me energji elektrike.

-Organet drejtuese të shoqërive të sistemit energjistik, OSHEE Group sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., të marrin masa për propozim për marrëveshje kompensimi/shuarje të Ministria e Financës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke pasqyruar situatën aktuale të detyrimeve të ndërsjella në sektor. Në marrëdhënien mes tre shoqërive duhet vlerësuar dhe mundësitë e pagesave nga Buxheti i Shtetit i këtyre detyrimeve por me garancinë që do të qarkullojnë në të gjitha shoqëritë e sistemit energjistik për të realizuar mbylljen e detyrimeve.

Ministria e Financës ose Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës mund të marrin përsipër të kryejnë pagesë për detyrimet e institucioneve buxhetore dhe ujësjellësve duke u garantuar që këto pagesa kalojnë nga FSHU sh.a. të OSSH sh.a. ose OSHEE sh.a. e cila mbyll detyrimin që ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. së pagesave për sektorin buxhetor në tërësi dhe të sektorit të Ujit në veçanti në periudhën vijuese.

### **I.1. Konkluzioni i auditimit**

-Situata e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sektorit të energjisë është komplekse dhe ka ardhur si rezultat i ndryshimeve ligjore në sektor, transformimit të shoqërive publike ndër vite dhe marrëdhënieve të ndërvarura mes tyre sipas modelit të tregut të energjisë. Përcaktimi i detyrimeve të ndërsjella, konsolidimi, ulja dhe kompensimi i tyre janë faktorë të rëndësishëm për të ndihmuar në transparencën dhe qartësinë e pasqyrave financiare të këtyre shoqërive, në qëndrueshmërinë financiare si dhe përmirësimin e aftësive likuiduese të tregut energjistik.

Me gjithë masat e marra nga ana e qeverisë, me miratimin e udhëzimeve, vendimeve si dhe caktimin e grupeve të përbashkëta për përmirësimin e problematikave të mësipërme, rezultoi që shoqëritë publike të sektorit energjistik nuk i kanë realizuar këto objektiva.

Në procesin e raportimit të detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare të shoqërive KESH, OSHEE dhe OST u konstatuan diferenca materiale si dhe mos dakordësi mes palëve për çështje të përcjella në organet gjyqësore.

Procesi i shlyerjes së detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes disa marrëveshjeve ristrukturimi afatgjatë mes kompanive. Në këtë proces detyrimin kryesor për pagesa e ka pasur OSHEE, ndaj KESH-it dhe OST-së, por që nuk është zbatuar në vlerat dhe afatet e përcaktuara. Detyrimet e ndërsjella të prapambetura ndikojnë në mënyrë negative në aftësinë paguese të sektorit energjistik, gjë e cila ndikon në rritjen e performancës, uljen e kostove dhe rritjen e investimeve.

Për të përballuar gjendjen e vështirë financiare dhe një mungesë të theksuar likuiditetesh KESH ka kërkuar mbështetjen si të Buxhetit të Shtetit ashtu edhe atë të bankave të nivelit të dytë. Në përgjigje të situatës emergjente Këshilli i Ministrave ka akorduar një Hua Buxhetore prej 68 milionë euro dhe fondin prej 20 miliardë lekë për mbështetjen e sektorit energjistik dhe në veçanti të KESH. Kërkesa për fonde emergjence ka sjellë rritjen nominale të borxhit publik shoqëruar me kostot e procedurave dhe interesit.

## II - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr.1076/1 prot., datë 12.09.2024, i ndryshuar, nga data 16.09.2024 deri në datën 27.12.2024, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë në shoqëritë OSHEE, KESH dhe OST me periudhë auditimi nga data 01.01.2020 deri më 30.11.2024.

Auditimi i përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B. Sh., Përgjegjës grupi
2. K. H., Auditues
3. E. S., Auditues

### 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimi:

Dhënia e konkluzionit në marrëdhëniet për detyrimet e ndërmjetme mes shoqërive OSHEE, KESH dhe OST, si dhe paraqitjen dhe evidentimin e detyrimeve të ndërsjellëta në pasqyrat financiare, dakordësitë dhe pretendimet. Procedurat, masat e marra nga organet drejtuese dhe grupet e ngritura të shoqërive publike në sistemin energjitik për zbatimin e parimeve udhëzuese të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, VKM-ve, urdhrave dhe marrëveshjeve përkatëse në lidhje me detyrimet e ndërsjellëta.

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional për vlerësimin e situatës debitoare në tërësi, zbatimi i masave të marra për evidentimin, adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe efektet e krijuara nga mos realizimi i objektivave të përcaktuara.

Mbi bazën e akt-konstatimeve, diskutimeve me zyrtarët e subjektit të audituar, vërejtjeve dhe sugjerimeve në takimin përmbyllës në terren, observacioneve të sjella hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### 2. Identifikimi i çështjes

Në procesin e ndarjeve dhe krijimit të shoqërive aksionere të reja në sektorin energjitik kanë lindur dhe detyrime të ndërsjella për këto shoqëri. Grupi të auditimit është fokusuar në evidentimin e detyrimeve në pasqyrat financiare,

i janë vendosur në dispozicion marrëveshjet që këto shoqëri kanë lidhur me njëra-tjetrën në lidhje me detyrimet e ndërsjella që këto shoqëri kanë.

1. Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018 midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH ose Kreditori) dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE ose Debitori). Amenduar me Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., datë 28.07.2021.

2. Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 2585 Prot., OST sh.a. dhe Nr. 3881 Prot., OSHEE sh.a., datë 15.04.2021 lidhur midis Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Kreditori) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE ose Debitori).

3. Marrëveshje për Shlyerje Detyrimesh të Prapambetura me Nr. 3327 Rep., Nr. 1127 Kol., datë 05.10.2021 lidhur midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH ose Kreditori) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Debitori).

Respektimi i kushteve kontraktore nga shoqëritë e sistemit energjitik.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara lidhur me çështjet nën auditim. Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia audituese të KLSH-së, është që të shprehin një opinion për paraqitjen e detyrimeve të ndërmjetme. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51. Përveç standardeve të ISSAI-it, ne aplikuar edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Kemi krijuar një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuam në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucioneve.

### **5. Kriteret e vlerësimit**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n, ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar.

Gjithashtu janë përdorur edhe Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit. Kushtetuta dhe Ligji Nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së.

## **6. Standardet e auditimit**

Auditimi bazohet në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”. Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSAI 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Rregullore e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

## **7. Metodat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

- a. *Metoda "Testim hap pas hapi"*: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.
- b. *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.
- c. *Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.
- d. *Metoda e inspektimit fizik*: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.
- e. *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së

informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

- f. *Metoda e testimit të detajuar:* Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

#### **8. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

### III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektet nën auditim

- Sistemi energjitik në Shqipëri përbëhet aktualisht nga tre shoqëri publike: KESH, OST dhe OSHEE, të ndara për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen dhe që e kanë zanafillën në KESH, e cila i përmbledhë dikur të tre këto aktivitete.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH), është prodhuesi publik dhe në të njëjtën kohë prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri. KESH ka nën administrim impiantet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike në vend. Këto asete përbëhen nga hidrocentralet e Kaskadës së Drinit, (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) me një fuqi të instaluar prej 1,350 mw. Kaskada e ndërtuar mbi Lumin Drin, është më e madhja në Ballkan si për nga kapaciteti i instaluar, ashtu edhe nga madhësia e veprave hidroteknike. Duke pasur në funksionim 79% të kapaciteteve prodhuese në vend, KESH furnizon rreth 70-75 % të kërkesës për energji elektrike të klientëve taritorë, siguron energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, si dhe nëpërmjet energjisë balancuese e shërbimeve ndihmëse garanton sigurinë e sistemit energjitik shqiptar. KESH ka si veprimtari themelore prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj në tregun e rregulluar dhe të pa rregulluar. KESH ka në administrim kaskadën më të madhe në rajon me një sipërfaqe ujëmbledhëse në Lumin Drin, e cila vlerësohet të jetë 14,173 km<sup>2</sup> më një gjatësi të rrjedhës prej 285 km.

- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është një shoqëri tregtare publike, me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. OST sh.a. është krijuar më 14 korrik 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta. OST është regjistruar në QKB më 1 shtator 2004 me NUIS K42101801N. OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit. Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. Selia qendrore e OST sh.a. është në autostradën Tiranë – Durrës, km 9, Yrshek, Kashar. OST sh.a. operon edhe me 7 njësi të tjera operative: Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit, me vendndodhje në Tiranë, pranë nënstacionit 35 kv; Njësia Operative Korçë, pranë nënstacionit Zemblak; Njësia Operative Fier, pranë TEC Fier, Njësia Operative Elbasan, pranë nënstacionit 220 KV, Bradashesh; Njësia Operative Shkodër, pranë nënstacionit 220 kv, Vau i Dejës; Njësia Operative Burrel, pranë nënstacionit 220 kv, Koms, Njësia Operative Tiranë, pranë nënstacionit 220 KV Tiranë. OST dispeçeron sistemin elektroenergjitik nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit, si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera. OST, si operator i tregut, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht, ka bërë që të kujdeset vazhdimisht për krijimin e një tregu të lirë të energjisë elektrike në Shqipëri si edhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me pronar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me Vendim Nr. 96 dhe 97 date 27.10.2014, të Bordit të Komisionarëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, Shoqëria është licencuar për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët taritorë.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është: a. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar; b. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejt të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: – ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve; – lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; dhe – instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike; c. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës si dhe d. Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vijim të procesit të ndarjes së aktivitetit të shpërndarjes sipas përcaktimeve të pika 1 të nenit 72, Ligji 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”, Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 157 dt. 12.02.2018 dhe Vendimit të Bordit të Komisionarëve të Entit Rregulator Nr. 211 datë 18.12.2019, OSHEE është ndarë në 3 shoqëritë e mëposhtme:

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.);
2. Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.);
3. Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. (FTL sh.a.).

## **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Paraqitja dhe evidentimi i detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare, dakordësitë dhe pretendimet përkatëse mes shoqërive publike në sistemin energjistik.**

-Përshkrimi i shkurtër i sektorit të energjisë

Sektori i Energjisë elektrike aktualisht është i rregulluar nga aktet e mëposhtëm:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;
- VKM Nr.519, datë 13.7.2016 “ Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar;
- VKM Nr.584, datë 08.10.2021 "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", i ndryshuar.
- Rregullore, udhëzime të tjera.

Në aspektin e organizimit të sektorit, subjektet pjesëmarrëse si dhe rolet e tyre paraqiten më poshtë:

- **Prodhues të energjisë elektrike**
  - KESH sh.a. gjeneruesi publik mbajtës i detyrimit për shërbim publik për furnizimin e energjisë për FSHU.
  - Gjenerues nga burimet e rinovueshme pjesë e skemave të mbështetjes.
  - Gjenerues të tjerë të pavarur.
- **Transmetimi i energjisë elektrike, veprimtari e ushtruar nga OST sh.a.**
- **Furnizimi tek konsumatori fundor kryhet nga FSHU:**

- Furnizuesi Universal, FSHU sh.a. i ngarkuar me detyrimin për shërbim publik për furnizimin e klientëve të lidhur në 0.4 KV dhe në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së fundit.
- Furnizues të tjerë të licencuar.
- **Shpërndarja e energjisë, veprimtari e ushtruar nga OSSH sh.a.**
- **Tregu i energjisë. Veprimtari e ushtruar për tregun e ditës në avancë nga ALPEX.**

Detyrimet e ndërsjella në sektor janë detyrime për marrëdhënie tregtare brenda sektorit, për kontratat për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik me energji elektrike (KESH – OSHEE) dhe të shërbimeve të balancimit dhe ribalancimit (KESH – OST – OSHEE Group), dhe detyrime të huamarrjeve, të cilat janë detyrime që palët i kanë njëra tjetrës në formën e nënhuasë, dhe kjo marrëdhënie rrjedh MFE - KESH sh.a. - OST sh.a. dhe Ministria e Financave -KESH sh.a. - OSHEE sh.a. dhe në detyrime të huave që secila nga palët KESH sh.a., OSHEE Group sh.a. dhe OST sh.a. i kanë direkt Ministrisë së Financave. Gjithashtu përveç shoqërisë OST sh.a., në shoqëritë KESH dhe OSHEE nuk janë aprovuar pasqyrat financiare të periudhave 2022 e 2023.

Në marrëdhëniet mes palëve ka mosdakordësi për detyrimet e ndërsjella.

**OSHEE me KESH, për periudhën deri më 31.12.2023, kanë një diferencë në vlerën 2,289,694,729 lekë.**

Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore midis KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. Në momentin e ndarjes së dy shoqërive në zbatim të Urdhrit të Ministrit (METE) Nr.500, datë 01.07.2015 “Për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet KESH sh.a dhe OSSH sh.a dhe marrëdhënieve tranzitore ndërmjet dy shoqërive”, si dhe VKM Nr. 862, datë 20.12.2006 “Për krijimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të cilat janë të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të KESH sh.a. Këto detyrime të OSSH/CEZ Shpërndarje/OSHEE ndaj KESH sh.a lidhen me balancat nga marrëdhëniet tranzitore midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a për periudhën 30.06.2008 deri më 31.12.2008 në vlerën 1,884,044,485 lekë. Kjo vlerë rrjedh nga pika Nr. 2 e Urdhrit Nr. 500, datë 01.07.2015 ku citohet: “.... Të gjitha të ardhurat e realizuara nga arkëtimet e energjisë elektrike të emetuara nga KESH sh.a për llogari të periudhës deri më 30.06.2008, të derdhen në llogaritë e KESH sh.a.”.

### **Detyrimet e prapambetura ndërmjet KESH-OST**

Sipas Akt Rakordimit të mbajtur midis Drejtorisë Ekonomike të KESH dhe OST sh.a. në datë 05.03.2024, detyrimet e OST ndaj KESH për energjinë, shërbimet, hua dhe interesa deri në 31.12.2023 janë 9,953,562,149 lekë ndërsa detyrimet e KESH ndaj OST 135,917,059 lekë sipas OST sh.a., ndërsa sipas KESH sh.a., detyrimet e OST sh.a. ndaj KESH sh.a. janë në vlerën 11,236,662,300 dhe KESH sh.a. ndaj OST sh.a. janë 135,817,000 duke pasur një difference në rakordim prej 1,283,100,210 lekë.

| Detyrimi   | Emërtimi i Llogarisë               | SIPAS OST sh.a.    |               |                    |               |
|------------|------------------------------------|--------------------|---------------|--------------------|---------------|
|            |                                    | Gjendje 30.12.2023 |               | Gjendje 30.11.2024 |               |
|            |                                    | KESH ndaj OST      | OST ndaj KESH | KESH ndaj OST      | OST ndaj KESH |
| KESH - OST | Blerje Energjie për disbalancat    | 41,130,513         |               | 214,921,195        |               |
| KESH - OST | Transmetim energjie                | 37,937,766         |               | 2,497,421          |               |
| KESH - OST | Shërbimi i transmetimit të dhënave | 232,801            |               | 465,601            |               |

|                     |                                           |                    |                      |                    |                      |
|---------------------|-------------------------------------------|--------------------|----------------------|--------------------|----------------------|
| KESH - OST          | Alokim kapacitetesh                       | 71,840             |                      | -                  |                      |
| KESH - OST          | Energji e aktivizuar                      | 11,274,542         |                      | 126,161,836        |                      |
| KESH - OST          | Humbje difference çmimi                   | 16,082,856         |                      | -                  |                      |
| KESH - OST          | Blerje e pafaturuar dhjetor               | 29,086,739.37      |                      | -                  |                      |
| OST - KESH          | Energji për disbalancat                   |                    | 2,336,051,621        |                    | 2,313,172,821        |
| OST - KESH          | Aktivizim rezerve                         |                    | 5,837,087,602        |                    | 5,099,857,822        |
| OST - KESH          | Humbje energjie                           |                    | 18,532,025.79        |                    | 0                    |
| OST - KESH          | Sherbime ndihmese                         |                    | 284,000,657          |                    | 213,276,336          |
| OST - KESH          | Fatura te pambritura dhjetor 2023 pa tvsh |                    | 36,078.53            |                    | 0                    |
| OST - KESH          | Marrëveshje për shlyerje detyrimesh       |                    | 1,477,854,166.00     |                    | 1,367,854,166        |
| <b>Totali</b>       |                                           | <b>135,817,058</b> | <b>9,953,562,149</b> | <b>344,046,052</b> | <b>8,994,161,145</b> |
| <b>Gjendja Neto</b> |                                           |                    | <b>9,817,745,091</b> |                    | <b>8,650,115,092</b> |

|                     |                                           | SIPAS KESH sh.a.   |                       |                    |                       |
|---------------------|-------------------------------------------|--------------------|-----------------------|--------------------|-----------------------|
| Detyrimi            | Emërtimi i Llogarisë                      | Gjendje 30.12.2023 |                       | Gjendje 30.11.2024 |                       |
|                     |                                           | KESH ndaj OST      | OST ndaj KESH         | KESH ndaj OST      | OST ndaj KESH         |
| KESH - OST          | Blerje Energjie për disbalancat           | (27,161,697)       |                       | 82,981,396         |                       |
| KESH - OST          | Transmetim energjie                       | 37,937,766         |                       | 2,497,962          |                       |
| KESH - OST          | Shërbimi i transmetimit te te dhënave     | 232,800            |                       | 465,600            |                       |
| KESH - OST          | Alokim kapacitetesh                       | 71,841             |                       | 0                  |                       |
| KESH - OST          | Energji e aktivizuar                      | 79,566,694         |                       | 126,161,836        |                       |
| KESH - OST          | Humbje difference cmimi                   | 16,082,856         |                       | 0                  |                       |
| KESH - OST          | Blerje e pafaturuar dhjetor               | 29,086,739.37      |                       | 0                  |                       |
| OST - KESH          | Energji per disbalancat                   |                    | 2,056,717,505         |                    | 1,934,217,844         |
| OST - KESH          | Aktivizim rezerve                         |                    | 7,594,275,877         |                    | 6,944,284,032         |
| OST - KESH          | Humbje energjie                           |                    | 18,532,039            |                    | 0                     |
| OST - KESH          | Shërbime ndihmese                         |                    | 284,000,659           |                    | 213,276,336           |
| OST - KESH          | Fatura te pambritura dhjetor 2023 pa tvsh |                    | 36,079                |                    | 36,079                |
| OST - KESH          | Marrëveshje për shlyerje detyrimesh       |                    | 0                     |                    | 0                     |
| OST - KESH          | Penalitete                                |                    | 1,283,100,142         |                    | 1,283,100,142         |
| <b>Totali</b>       |                                           | <b>135,817,000</b> | <b>11,236,662,301</b> | <b>212,106,794</b> | <b>10,374,878,354</b> |
| <b>Gjendja Neto</b> |                                           |                    | <b>11,100,845,301</b> |                    | <b>10,162,771,560</b> |

**OST me KESH kanë një diferencë në vlerën 1,512,656,468 lekë.**

Kjo diferencë përbëhet nga faturat e papranuara nga OST që janë fatura penaliteti për moslikujdim në afat te cilat kapin vlerën 1,283,100,142 lekë.

Në datën 05.10.2021, me Nr. 4859 Prot, mes KESH sh.a. dhe OST sh.a. është nënshkruar

Marrëveshja për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 1.747.854.166 lekë për detyrimin e disbalancave. OST e ka respektuar në përgjithësi skedulin e pagesave të kësaj marrëveshjeje.

Ndërsa diferenca e mbetur 229,556,258 lekë vjen si rezultat i marrëdhënieve midis shoqërive deri në 30.11.2024 për energji për disbalancat, aktivizim rezerve dhe shërbime të tjera gjatë vitit.

### **Problematika e detyrimeve ndërmjet KESH dhe Ministrisë së Financave.**

Në pasqyrat financiare të KESH sh.a. rezulton një detyrim në vlerën 1,330,000,000 lekë ndaj Ministrisë së Financave. Detajet e këtij detyrimi shtjellohen si më poshtë:

Në vitet 1999-2001 KESH sh.a. ka nënshkruar tre marrëveshje huaje me Ministrinë e Financave, konkretisht:

-Në vitin 1999 - Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 650 milionë lekë me objekt “Përballimi i kostove të huaja të importit të energjisë elektrike dhe transprotit të transformatorëve të HEC Fierze”.

-Në vitin 2000 - Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 240 milionë lekë me objekt “Përballimi i borxhit të vjetër ndaj kompanisë Greke nga KESH-i, si rezultat i bilancit negativ në shkëmbimin e energjisë elektrike”.

-Në vitin 2001 - Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 440 milionë lekë me objekt “Përballimi i borxhit të vjetër ndaj kompanisë Greke nga KESH-i, si rezultat i bilancit negativ në shkëmbimin e energjisë elektrike”.

Nga periudha e nënshkrimit të Marrëveshjeve nga Ministria e Financave, nuk është dërguar asnjë njoftim për shlyerjen e këtyre detyrimeve nga ana e KESH sh.a.

Nga rakordimet që KESH sh.a. ka bërë me Ministrinë e Financave/ Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik, lidhur me protofolin e kredive që KESH sh.a. ka me Ministrinë, këto tre Marrëveshje nuk rezultonin në listën e tyre të huave të marra nga KESH sh.a, deri më 01.10.2020. Me shkresën Nr. 10449/1, datë 01.10.2020, protokolluar në KESH sh.a. me Nr. 1684/1 datë 02.10.2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë njeh detyrimin për këto hua, të cilat i përkasin viteve 1999-2001.

Nga kjo periudhe Ministria ka llogaritur edhe penalitetet duke filluar nga viti i parë i ri pagesës së huave dhe deri në datën e njohjes së tyre nga Ministria.

### **Marrëdhëniet OSHEE me OST**

Sipas Akt Rakordimit i mbajtur më datë 06.03.2024 midis Departamentit Ekonomik të OSHEE Sh.a dhe Drejtorisë Ekonomike të OST sh.a. mbi balancat e llogarive deri më 31.12.2023 ekzistojnë detyrimet e ndërsjella si më poshtë:

#### **Detyrimet e ndërsjella OSHEE Grup - OST deri me 31.12.2023 dhe 30.11.2024. – SIPAS OSHEE**

|          |                                                         | Sipas Oshee        |                | Leke               |                | Leke          |             |
|----------|---------------------------------------------------------|--------------------|----------------|--------------------|----------------|---------------|-------------|
| Detyrimi | Emërtimi i Llogarisë                                    | Gjendje 30.12.2023 |                | Gjendje 30.11.2024 |                |               |             |
|          |                                                         | OSHEE ndaj OST     | OST ndaj OSHEE | OSHEE ndaj OST     | OST ndaj OSHEE |               |             |
| FTL-OST  | Transmetim energjie                                     | 4,874,356          |                |                    |                | 57,679,297    |             |
| FTL-OST  | Disbalanca                                              | 5,887,669,742      |                |                    |                | 5,422,033,942 |             |
| FTL-OST  | Disbalanca (Fatura te pafaturuara) dhjetor 2023 pa Tvsh | 1,198,330          |                |                    |                |               |             |
| OST-FTL  | Disbalanca                                              |                    |                | 947,098,633        |                |               | 639,435,620 |
| OST-FTL  | Disbalanca-(Fatura te pamblitura) dhjetor 2023 pa Tvsh  |                    |                | 1,981,099          |                |               |             |

|               |                                                       |                       |                         |                       |                         |
|---------------|-------------------------------------------------------|-----------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|
| FSHU-OST      | Transmetim energjie                                   | 974,947,813           |                         | 1,023,486,329         |                         |
| OSHEE-OST     | Mareveshje per shlyerje detyrimesh                    | 8,909,229,200         |                         | 8,549,229,200         |                         |
| OSHEE-OST     | Energji per disbalancat 2016-2017 gjyq                | -                     |                         | -                     |                         |
| OSHEE-OST     | Sherbim per automjetet e vena ne dispozicion nga NJMT | 678,102               |                         | 678,102               |                         |
| OSHEE-OST     | Penalitet per faturen 497 dt 31.12.2015               |                       |                         | -                     |                         |
| OST per OSHEE | IRTC                                                  |                       | 5,493,895               |                       | 5,493,895               |
| OST per OSHEE | Detyrim I transferimit te asetëve                     |                       | 29,326,601              |                       | 29,326,601              |
|               | <b>Totali</b>                                         | <b>15,778,597,542</b> | <b>983,900,228</b>      | <b>15,053,106,869</b> | <b>639,435,620</b>      |
|               | <b>Gjendja Neto</b>                                   |                       | <b>(14,794,697,314)</b> |                       | <b>(14,413,671,250)</b> |

**Detyrimet e ndërsjella OSHEE Grup - OST deri më 31.12.2023 dhe 30.11.2024. – SIPAS OST**

| Detyrimi            | Emertimi i Llogarise                                    | Leke                  |                         | Leke                  |                         |
|---------------------|---------------------------------------------------------|-----------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|
|                     |                                                         | Gjendje 30.12.2023    |                         | Gjendje 30.11.2024    |                         |
|                     |                                                         | OSHEE ndaj OST        | OST ndaj OSHEE          | OSHEE ndaj OST        | OST ndaj OSHEE          |
| FTL-OST             | Transmetim energjie                                     | 4,874,355             |                         | 57,679,296            |                         |
| FTL-OST             | Disbalanca                                              | 5,887,669,742         |                         | 5,422,033,941         |                         |
| FTL-OST             | Disbalanca (Fatura të pafaturuara) dhjetor 2023 pa tvsh | 1,198,330             |                         |                       |                         |
| OST-FTL             | Disbalanca                                              |                       | 947,098,643             |                       | 639,435,619             |
| OST-FTL             | Disbalanca-(Fatura të pambritura) dhjetor 2023 pa tvsh  |                       | 1,981,098               |                       |                         |
| FSHU-OST            | Transmetim energjie                                     | 974,947,814           |                         | 1,026,375,429         |                         |
| OSHEE-OST           | Marrëveshje për shlyerje detyrimesh                     | 8,909,229,200         |                         | 8,549,229,200         |                         |
| OSHEE-OST           | Energji për disbalancat 2016-2017 gjyq                  | 2,378,241,772         |                         | 2,272,722,889         |                         |
| OSHEE-OST           | Shërbim për automjetet e vëna në dispozicion nga NJMT   | 2,932,520             |                         | 2,932,520             |                         |
| OSHEE-OST           | Penalitet për faturën 497 dt 31.12.2015                 | 490,054               |                         | 490,054               |                         |
| <b>Totali</b>       |                                                         | <b>18,159,583,786</b> | <b>949,079,741</b>      | <b>17,331,463,329</b> | <b>639,435,619</b>      |
| <b>Gjendja Neto</b> |                                                         |                       | <b>(17,210,504,045)</b> |                       | <b>(16,692,027,710)</b> |

Shënimet sqaruese për detyrimet e OSHEE Grup ndaj OST sh.a.:

- “Vlera 2,254,417 lekë” Shërbim për automjetet e vëna në dispozicion nga NJMT" përbëhet nga fatura të lëshuara nga OST sh.a për shërbime të kryera gjatë vitit 2015 por që nuk pranohen si detyrim nga ana e OSHEE sh.a.
- “Vlera 490,054 leke” Penalitet i faturuar për vonesat në kryerjen e pagesës së faturës Nr. 497, Dt 31.12.2015", lëshuar nga OST sh.a. ndaj OSHEE sh.a, për të cilën Oshee nuk ka asnjë dijeni për këtë faturë, dhe e konsideron si të pavlefshme sepse është në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Vlera 2,378,241,772 lekë është faturë e lëshuar nga OST ndaj OSHEE Grup në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, dërguar pranë OSHEE me shkresën Nr. 4003, datë 31.05.2018. OSHEE me shkresën Nr. 10615/1, datë 11/06/2018 ka kthyer pa veprim faturat dhe ka ndjekur rrugë gjyqësore për kontestimin e vendimit të lartpërmendur. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 3851, datë 29.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së OSHEE-së si të pabazuar në ligj dhe në prova. OSHEE ka apeluar vendimin dhe çështja vijon të jetë në gjykim. OST me kërkesë-padinë Nr. 7475, datë 31.10.2018, ka kërkuar njohjen e detyrimit nga OSHEE dhe pagesën e faturave. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, (me kërkesë të palës paditur OSHEE), Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 3809, datë 13.03.2019 vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se duke qenë se padia e OST-së është mbështetur në vendimin Nr. 110, datë

14.05.2018 të ERE, çështja nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur më parë në Gjykatën Administrative të Apelit me vendim të formës së prerë. Aktualisht, bazuar edhe në vendimet gjyqësore të përmendura më lart, vendimi i ERE Nr. 110, datë 14.05.2018 mbetet në fuqi.

Shënimet sqaruese për të drejtat e OSHEE Grup ndaj OST sh.a.:


- "Vlera 5,493,894 lekë për zërin IRTC "përbëhet nga fatura Nr. 27 datë 26.01.2018 dhe fatura Nr. 29 datë 19.02.2018 që nuk janë pranuar nga OST sipas shkresës Nr. 749/7 datë 06.03.2018.
- "Vlera 29,326,601 lekë është tvsh e faturës Nr. 1 datë 31.03.2018 "Sipas Raportit të Audituesit Ligjor dhe Marrëveshjes datë 02.05.2018. Vlera e aseteve në aneksin Nr. 1 është 146,633,003.67 lekë. Tvsh është detyrim për pagesë nga ana e OST sipas procedurave fiskale referuar kontratës mes dy shoqërive si dhe raportit të Audituesit ligjor të lëshuar për Oshee sh.a.. Ndërkohë që për OST sh.a., Audituesi Ligjor që ka ndjekur transferimin e aseteve e ka trajtuar si tvsh të pazbritshme, duke bërë që OST këtë tvsh t'a përfshijë në koston e aseteve. Raporti i Audituesit Ligjor është miratuar me shkresën e MFE-së Nr. 16342/1, datë 15.10.2018 dhe ka vendosur që kjo vlerë të regjistrohet në pasqyrat financiare të OST-së në zërin grant.

**Diferenca nga rakordimi i detyrimeve të prapambetura midis shoqërive OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. është në vlerën 2,278,356,468 lekë.**

Shoqëritë publike të sistemit energjitik OSHEE, KESH dhe OST i referohen Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në hartimin e pasqyrave financiare si dhe detyrimeve të ndërsjella. Një problematikë e konstatuar është mos aprovimi i pasqyrave financiare në afatet ligjore nga organet drejtuese si Këshillat Mbikëqyrës dhe Asamblëtë e Ortakëve, për shoqërinë OSHEE sh.a., dhe KESH sh.a.

Në lidhje me detyrimet mes palëve dakordësimet nga përfaqësuesit zyrtarë nuk janë bërë më pas vitit 2021, kur rakordime në nivelet e drejtorive financiare të shoqërive bëhen në mënyrë periodike.

Vlerat në miliard lekë



- **OSHEE me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.2 miliardë lekë.** Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore dhe penalitete të ndryshme midis palëve.
- **OST me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 1.5 miliardë lekë.** Kjo diferencë përbëhet nga faturat e papranuara nga OST që janë fatura penaliteti për moslikujdim në afat, si dhe diferenca që vijnë si rezultat i marrëdhënieve midis shoqërive deri në 30.11.2024 për energji për disbalancat, aktivizim rezerve dhe shërbime të tjera gjatë vitit.
- **OSHEE me OST, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.3 miliardë lekë,** e cila është faturë e lëshuar nga OST ndaj OSHEE në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, vlerë e ankimuar në gjykatë.

**2.2. Procedurat, masat e marra nga organet drejtuese dhe grupet e ngritura të shoqërive publike në sistemin energjistik për zbatimin e parimeve udhëzuese të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, VKM-ve, urdhrave dhe marrëveshjeve përkatëse në lidhje me detyrimet e ndërsjella**

### **1. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE Grup).**

Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018 midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH ose Kreditori) dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE ose Debitori). Amenduar me Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., datë 28.07.2021.

## **2. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE Grup).**

Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 2585 Prot., OST sh.a. dhe Nr. 3881 Prot., OSHEE sh.a., datë 15.04.2021 lidhur midis Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Kreditori) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE ose Debitori).

## **3. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) - Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST).**

Marrëveshje për Shlyerje Detyrimesh të Prapambetura me Nr. 3327 Rep., Nr. 1127 Kol., datë 05.10.2021 lidhur midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH ose Kreditori) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Debitori).

Historiku i krijimit dhe transformimit të këtyre institucioneve.

Në vitin 1957, është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Centraleve Elektrike (DPCE) si entiteti i vetëm që realizonte prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike tek konsumatori si edhe shkëmbimin me vendet fqinj.

Në vitin 1992, DPCE u shndërrua në ndërmarrjen shtetërore Korporata Elektroenergjitike Shqiptare. Në vitin 1995 mori statusin e shoqërisë anonime me aksione të zotëruara 100% nga shteti. Në vitin 2001, hyri në fuqi Statuti aktual i KESH sh.a., i cili parashikonte ndryshime të thella organizative në zbatim të legjislacionit komunitar për privatizimin e monopoleve jonatyrle – si kusht kryesor për integrimin e Shqipërisë në BE – duke bërë fillimisht ndarjen e funksioneve bazë *Prodhim, Transmetim, Shpërndarje*.

Me zhvillimet e mëvonshme, në vitin 2004 u bë ndarja nga KESH sh.a. e veprimtarisë së transmetimit nëpërmjet krijimit dhe funksionimit më vete në treg të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. si shoqëri anonime me aksione 100% shtetërore.

Në vitin 2007, u nda nga KESH sh.a. shpërndarja dhe furnizimit me pakicë dhe u krijua Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. fillimisht si shoqëri me aksione 100% shtetërore, e cila në vitin 2009, u privatizua ku 76% të aksioneve, u bë pjesë e grupit CEZ A.S. Si rezultat i keq menaxhimit nga CEZ, kompania u vendosur në administrim të përkohshëm publik për gati një vit. CEZ Shpërndarje emërtohet OSHEE në Prill 2014. Pronësia e OSHEE-së në maj 2016 ka kaluar pranë MEI. Shoqëria OSHEE Grup, pas ndarjes ka në përbërjen tre shoqëri tregtare.

-Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH

-Furnizuesi i Shërbimit Universal – FSHU

-Furnizuesi i Tregut të Lirë - FTL

KESH sh.a. ushtroi veprimtarinë e Prodhimit, Furnizimit Publik me Shumicë dhe Tregtimit të Energjisë Elektrike. Aksionet e Shoqërisë zotërohen 100 % nga Shteti Shqiptar

KESH nuk ka më funksionin e furnizimit Publik me Shumicë dhe përqendrohet në prodhimin e tregtimit të energjisë elektrike si dhe mirëmbajtjen e zhvillimin e veprave.

Shoqëria KESH sh.a. ka detyrimin për shërbimin publik edhe për kategorinë e konsumatorëve që lidhen në nivel tensioni 0.4/6/10/20 kv, si dhe blerjen e humbjeve në sistemin e transmetimit të tensionit të lartë për OST.

Përgjatë këtij rrugëtimi të ndarjeve dhe krijimit të shoqërive aksionare të reja kanë lindur dhe detyrime të ndërsjella për këto shoqëri. Grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion marrëveshjet që këto shoqëri kanë lidhur me njëra-tjetrën në lidhje me detyrimet e ndërsjella që këto shoqëri kanë.

Këto marrëveshje janë trajtuar si më poshtë:

**Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018 midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH) dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE).**

Në këtë marrëveshje, KESH ose “Kreditori” kanë rënë dakord me OSHEE ose “Debitori” për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Këto detyrime kanë lindur midis Kreditorit dhe Debitori pasi nga viti 2008 deri në vitin 2016, palët e mësipërme kanë hyrë në disa marrëveshje tregtare për shitjen e energjisë.

Nga mos zbatimi i marrëveshjeve tregtare që janë lidhur për periudhën 2008-2016, Debitori (OSHEE) i detyrohet Kreditorit (KESH) vlerën prej 51,438,460,429 lekë. Ky detyrim është përbërhet në 40,853,480,443 lekë për fatura shitjeje energjie dhe 10,584,979,986 lekë penaltete.

Për këtë qëllim Kreditori dhe Debitori kanë nënshkruajné këtë Marrëveshje me qëllim shlyerjen e plotë, të pakushtëzuar dhe përfundimtare të të gjithë detyrimit nga Debitori tek Kreditori në përputhje me afatet dhe kushtet e Marrëveshjes dhe Skedulit të Ripagimit. Palët me këtë marrëveshje kanë rënë dakord që Debitori të paguaj të gjithë detyrimin në pagesa vjetore, duke filluar nga viti 2018 derisa ky detyrim të shlyhet plotësisht, të strukturuar në mënyrë që Kreditori të përmbushë “Raportin e Mbulimit të Borxhit/Raportit të Mbulimit të Shpenzimeve” (DSCR/RMSHB) minimale prej 1.2x për vitin financiar paraardhës. Çdo pagese vjetore, me përjashtim të vitit 2018, do të strukturohet si shuma e përbërë nga një pjesë fikse dhe një pjesë e ndryshueshme. Pjesa fikse do të jetë e barasvlershme me këstin në euro sipas planit të shlyerjes në shtojcën 1 dhe pjesa e ndryshueshme është diferenca e fluksit të nevojshëm të parave që i duhet Kreditorit për të përmbushur një DSCR minimale prej 1.2x për vitin paraardhës me pjesën Fikse, kur kjo diferencë është më e madhe se zero. Debitori i paguan Kreditorit pjesën e ndryshueshme me kusht që Kreditori të ketë bërë të gjitha përpjekjet për të përmbushur DSCR duke përdorur më parë të gjithë Fondin e Rezervës të themeluar sipas VKM Nr. 729, datë 08.12.2017. Pjesa e ndryshueshme do të fillojë të aplikohet nga viti 2019 dhe në vijim, derisa detyrimi të ri paguhet plotësisht. Pagesat do të ofrohen Kreditorit në një kësht vjetor të pagueshëm në 1 tetor deri në vitin 2022. Nga viti 2023 pagesat do të kryhen në dy kështe gjashtëmujore, të pagueshme më 1 prill dhe 1 tetor.

Debitori, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë gjithë periudhës kohore të kërkuar për pagesën e përcaktuar në Planin e Pagesave, do të hapë dhe mbajë një llogari bankare brenda një banke të rënë dakord nga Palët, ku debitori duhet të depozitojë një shumë jo më të vogël se “Kësti vjetor i vitit përkatës sipas Aneksit 1” me qëllim garantimin e pagesës së detyrimit sipas Planit të Pagesës.

KESH sh.a. dhe OSHEE Group sh.a. në datën 22.04.2021 është lidhur marrëveshje për shuarjen e detyrimeve, (protokolluar në KESH me Nr. 2316 prot., dhe në OSHEE me Nr. 4066 prot.). Palët nëpërmjet kompensimit (Netimi i detyrimeve) kanë hartuar akt rakordimet për detyrimet reciproke deri më datë 31.12.2020. Bazuar në këtë akt rakordim kanë treguar vullnet për aplikimin e mekanizmit të shuarjes me kompensim të detyrimeve reciproke për të vijuar marrëdhënien mes palëve të pa shqetësuar nga këto pretendime dhe mosmarrëveshje.

Në datën 28.07.2021 Kreditori dhe Debitori kanë nënshkruar një amendim të marrëveshjes me Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., me qëllim realizimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018. Ky amendim është bërë pasi palët kanë evidentuar dhe dakordësuar se gjatë periudhës 31.12.2016 (periudhë e marrë si reference për përcaktimin e detyrimeve) dhe deri në lidhjen e akt rakordimit të datës 31.12.2020, ka pasur në mënyrë reciproke mos përmbushje detyrimesh të tjera, të pa përfshira në marrëveshje

dhe që sjellin ndryshime në shumën e detyrimit objekt i marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018. Debitori dhe Kreditori pranojnë se që nga data 01.01.2017 dhe përgjatë zbatimit të marrëveshjes nga ana e tyre ka patur mos përmbushje të disa detyrimeve ndaj njërit-tjetrit. Për qëllim të rakordimit të detyrimeve dhe ndryshimit të marrëveshjes së nënshkruar në 06.04.2018, palët kanë realizuar një akt rakordimin duke përcaktuar shumën totale të detyrimit që debitori ka ndaj kreditorit. Kjo shumë është 48,910,915,441 lekë. Palët kanë realizuar mes tyre në zbatim të akt rakordimit të detyrimeve të datës 31.12.2020, marrëveshjen e shuarjes me kompensim të detyrimeve (marrëveshje netimi detyrimesh) reciproke të akumuluar, me Nr. 2316 Prot., KESH sh.a. dhe Nr. 4066 Prot., OSHEE sh.a., datë 22.04.2021. Ndryshimet në marrëveshjen ekzistuese të fillojnë efektet në datën 31.12.2020, datë në të cilën mes palëve është hartuar dhe akt rakordimi i detyrimeve të ndërsjella. Këto ndryshime do të realizohen sipas aneksit 1 të amendimit të marrëveshjes. Ky aneks do të bëhet pjesë e marrëveshjes kryesore. Të gjitha parashikimet e tjera të marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218 mbeten të pandryshuara.

#### SKEDULI I RIPAGIMIT

| SKEDULI I RIPAGIMIT  REPAYMENT SCHEDULE |               |                  |                     |
|-----------------------------------------|---------------|------------------|---------------------|
| Viti  Year                              | Pjesa fikse   | Pjesa fikse      | Vlera e mbetur      |
|                                         | Fixed portion | Fixed portion    | Outstanding balance |
|                                         | ne in EUR     | ne in ALL        | ne in ALL           |
|                                         |               |                  | 48,910,915,441.90   |
| 2021                                    | 17,116,244.00 | 2,276,460,452.00 | 46,634,454,989.90   |
| 2022                                    | 16,984,752.00 | 2,258,972,016.00 | 44,375,482,973.90   |
| 2023                                    | 16,853,260.00 | 2,241,483,580.00 | 42,133,999,393.90   |
| 2024                                    | 16,725,661.00 | 2,224,512,913.00 | 39,909,486,480.90   |
| 2025                                    | 16,590,276.00 | 2,206,506,708.00 | 37,702,979,772.90   |
| 2026                                    | 16,458,784.00 | 2,189,018,272.00 | 35,513,961,500.90   |
| 2027                                    | 16,327,292.00 | 2,171,529,836.00 | 33,342,431,664.90   |
| 2028                                    | 16,197,962.00 | 2,154,328,946.00 | 31,188,102,718.90   |
| 2029                                    | 16,064,308.00 | 2,136,552,964.00 | 29,051,549,754.90   |
| 2030                                    | 15,932,815.00 | 2,119,064,395.00 | 26,932,485,359.90   |
| 2031                                    | 15,801,323.00 | 2,101,575,959.00 | 24,830,909,400.90   |
| 2032                                    | 17,287,408.00 | 2,299,225,264.00 | 22,531,684,136.90   |
| 2033                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 21,064,430,397.90   |
| 2034                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 19,597,176,658.90   |
| 2035                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 18,129,922,919.90   |
| 2036                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 16,662,669,180.90   |
| 2037                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 15,195,415,441.90   |
| 2038                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 13,728,161,702.90   |
| 2039                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 12,260,907,963.90   |
| 2040                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 10,793,654,224.90   |
| 2041                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 9,326,400,485.90    |
| 2042                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 7,859,146,746.90    |
| 2043                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 6,391,893,007.90    |
| 2044                                    | 11,031,983.00 | 1,467,253,739.00 | 4,924,639,268.90    |

|              |                       |                          |                  |
|--------------|-----------------------|--------------------------|------------------|
| 2045         | 11,031,983.00         | 1,467,253,739.00         | 3,457,385,529.90 |
| 2046         | 25,995,379.92         | 3,457,385,529.90         | -                |
| <b>TOTAL</b> | <b>367,751,243.92</b> | <b>48,910,915,441.90</b> |                  |

(Aneksi Nr.1 i cili u bë pjesë integrale e marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218 pas amendimit Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., datë 28.07.2021)

### Zbatimi i marrëveshjes

Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ana e shoqërisë KESH sh.a. dhe OSHEE Group sh.a. shkresat dhe pagesat e OSHEE Group për vitet 2018-2020 (periudhë para marrëveshjes së netimit dhe amendimit të kontratës) dhe pagesat për vitet 2023-2024 (pas amendimit të kontratës dhe vendosjes së aneksit Nr.1 si pjesë integrale e marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218) janë si më poshtë:

| Viti         | Shuma ne EUR      | Shuma ne ALL         | Pagesa ne EUR     | Pagesa ne ALL        | Dt e pageses |
|--------------|-------------------|----------------------|-------------------|----------------------|--------------|
| 2018         | 5,300,000         | 704,900,000          | 5,300,000         | 667,323,000          | 02/10/2018   |
| 2019         | 17,379,228        | 2,311,437,324        | 9,783,789         | 1,200,000,000        | 1-28/10/2019 |
| 2020         | 17,253,359        | 2,294,696,747        | 7,600,000         | 942,628,000          | 08/10/2020   |
| <b>TOTAL</b> | <b>39,932,587</b> | <b>5,311,034,071</b> | <b>22,683,789</b> | <b>2,809,951,000</b> |              |

(Tabelë e vendosur në dispozicion nga KESH sh.a. bazuar ne Aneksin 1 të marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218)

| Viti | Shuma ne EUR | Shuma ne ALL  | Pagesa ne EUR | Pagesa ne ALL    |
|------|--------------|---------------|---------------|------------------|
| 2021 | 17,116,244   | 2,276,460,452 |               | -                |
| 2022 | 16,984,752   | 2,258,972,016 |               | -                |
| 2023 | 16,853,260   | 2,241,483,580 |               | 1,300,000,000.00 |
| 2024 | 16,725,661   | 2,224,512,913 |               | 700,000,000.00   |
| 2025 | 16,590,276   | 2,206,506,708 |               |                  |
| 2026 | 16,458,784   | 2,189,018,272 |               |                  |
| 2027 | 16,327,292   | 2,171,529,836 |               |                  |
| 2028 | 16,197,962   | 2,154,328,946 |               |                  |
| 2029 | 16,064,308   | 2,136,552,964 |               |                  |
| 2030 | 15,932,815   | 2,119,064,395 |               |                  |
| 2031 | 15,801,323   | 2,101,575,959 |               |                  |
| 2032 | 17,287,408   | 2,299,225,264 |               |                  |
| 2033 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |
| 2034 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |
| 2035 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |
| 2036 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |
| 2037 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |
| 2038 | 11,031,983   | 1,467,253,739 |               |                  |

|              |                    |                       |          |                      |
|--------------|--------------------|-----------------------|----------|----------------------|
| 2039         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2040         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2041         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2042         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2043         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2044         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2045         | 11,031,983         | 1,467,253,739         |          |                      |
| 2046         | 25,995,380         | 3,457,385,530         |          |                      |
| <b>TOTAL</b> | <b>367,751,244</b> | <b>48,910,915,442</b> | <b>-</b> | <b>2,000,000,000</b> |

(Tabelë e vendosur në dispozicion nga KESH sh.a. bazuar në Aneksin Nr.1 i amendaur, i marrëveshjes Nr.208 Rep., Nr.97 Kol datë 06.04.2018)

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 4082 prot., datë 01.10.2019 i është drejtuar OSHEE sh.a. për pagesën e kështit të radhës sipas marrëveshjes “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” Nr. 208 Rep., Nr.91 Kol., datë 06.04.2018. KESH sh.a. ka kërkuar shlyerjen e kështit të vitit 2019 pjesa fikse sipas skedulit të marrëveshjes. Kjo shumë është ekuivalente në Lek me kursin e BSH-së në vlerën 17,379,228 euro shumë e cila duhet të jetë gjendje në llogarinë Escrow të hapur në favor të KESH, në përmbushje të nenit 2.3-2.7 të marrëveshjes ndërmjet KESH-OSHEE.

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 4082/1 prot., datë 08.10.2009 i është drejtuar përsëri OSHEE sh.a. dhe për dijeni MIE duke e njoftuar se sipas skedulit të pagesave për kështin e vitit 2019 shuma është 17,379,228 euro, por deri në datën 07.10.2019 është paguar vetëm një pjesë e detyrimit konkretisht shuma 700 milionë ose 5,728,558 euro. Referuar sa më sipër dhe në zbatim të nenit 2.2 të marrëveshjes të merren masa që të bëhet pagesa e pjesës së mbetur të kështit për vitin 2019.

-OSHEE sh.a. i ka kthyer përgjigje KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 20179/2 prot., datë 09.10.2019.

Në përgjigje të kërkesës për pagesën e pretenduar sipas shkresës me Nr. 4082 prot., datë 01.10.2019 “Mbi pagesën e kështit të radhës sipas marrëveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” OSHEE sh.a. e ka parë të arsyeshme të paguaj vetëm një pjesë të detyrimit sipas marrëveshjes duke marrë parasysh se:

- Mos furnizimi nga KESH i sasisë së energjisë së planifikuar sipas programit financiar të miratuar nga MIE për vitin 2019 prej 3,950 Gwh me një diferencë prej rreth 1,250 Gwh (sipas parashikimit të KESH-it të sasisë që do të furnizohet prej rreth 2,700 Gwh), e ka detyruar OSHEE që të blejë këtë sasi në tregun e lirë të energjisë me një kosto të shtuar prej rreth 7.2 lekë/kwh. Kjo shtesë në shpenzimet për blerjen e energjisë i ka shkaktuar OSHEE deri në 30.09.2019 një humbje prej 6.4 miliardë lekë e cila pritët të shkojë në rreth 9 miliardë lekë deri në fund të vitit 2019.

- Marrëveshja “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” datë 06.04.2018 ndërmjet OSHEE dhe KESH, cituar në shkresën tuaj, u nënshkruan në kuadrin e zbatimit të marrëveshjes së huasë lidhur midis KESH dhe BERZH lidhur me “mbajtjen e Raportit të Mbulimit të Shërbimit të Borxhit prej 1.2x gjatë gjithë kohës”, sipas paragrafit Historiku pika C të kësaj marrëveshje. Në fakt, rezulton që kushtet marrëveshjes së KESH me BERZH kanë ndryshuar në zvogëlim të sasisë që parashikohej të disbursohej, duke ndryshuar edhe kushtet bazë të marrëveshjes ndërmjet OSHEE dhe KESH, të cilat duhet të rishikohen. Llogaritja e Pagës së Detyrimit sipas pikës 2 të marrëveshjes dhe programi i ri pagimit në tabelën e Aneksit 1 duhet të rishikohet gjithashtu.

*OSHEE është në pritje, që KESH të dërgojë rillogaritjen e Raportit të Mbulimit të Borxhit në lidhje me Marrëveshjen e Huasë lidhur me BERZH si dhe programin e pagesave të parashikuara në Aneksin 1 (të rishikuar), për të bërë parashikimin e pagesave vjetore në nenin 2.2.*

*Sa më sipër, ju njoftojmë se OSHEE do të paguajë vetëm një pjesë të detyrimit sipas marrëveshjes.*

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr.2799 prot., datë 15.09.2020 i është drejtuar FSHU sh.a. dhe OSHEE sh.a., për dijeni MIE për shlyerjen e detyrimeve financiare. KESH ka kërkuar shlyerjen e detyrimeve nga FSHU sh.a. pjesë e OSHEE Group për periudhën Janar-Korrik 2020 për furnizimin me energji për klientët tariforë nga e cila ka ngelur pa paguar shume prej 395 milionë lekë dhe diferencën e papaguar në vlerën prej 7.595 milionë euro nga OSHEE sh.a. për kështin e vitit 2019 bazuar në marrëveshje. Bazuar në skedulin e kësaj marrëveshje deri në datën 1 Tetor 2020 nga ana e OSHEE duhet të paguhet kështi i vitit 2020 në vlerën 17.253 milionë euro.

-OSHEE sh.a. me anë të shkresës Nr. 10137 prot., datë 07.10.2020 i është drejtuar KESH sh.a. dhe për dijeni MF dhe MIE. Me anë të kësaj shkrese OSHEE informon KESH për kështin e radhës sipas marrëveshjes “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

OSHEE informon se në kuadër të marrëveshjes “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” në datën 07.10.2020 ka vijuar me likuidimin e kështit të radhës në vlerën 7,600,000 euro. Pagesa prej 7,600,000 euro përkon me detyrimin që KESH sh.a. i detyrohet EBRD (BERZH) për kështin e datës 12.10.2020, bazuar në informacionin e sjell nga EBRD (BERZH).

Nga dokumentacionet e mësipërme konstatohet se OSHEE Group ka vepruar në mospërputhje me marrëveshjen Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218 që ka nënshkruar dhe kjo ka sjelle nevojën për rishikim të kësaj marrëveshje dhe lidhjen e Amendimit Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., datë 28.07.2021.

Pas amendimit të marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218 dhe vendosjes së Aneksit 1 të amenduar, KESH sh.a. i është drejtuar me shkresën Nr. 228 prot., datë 17.01.2022 Shoqërisë FSHU sh.a. dhe OSHEE sh.a., për dijeni MIE për shlyerjen e detyrimeve financiare. Me anë të kësaj shkrese dhe bazuar në aneksin Nr.1, KESH sh.a. kërkon nga OSHEE Group vlerën e kështit për vitin 2021 prej 17,116,244 euro për detyrimet e prapambetura nga FSHU sh.a. pjesë e OSHEE Group në vlerën prej 2,441 milionë lekë për periudhën Gusht-Dhjetor 2021. Për shlyerjen e këtyre detyrimeve KESH sh.a. ka vendosur si afat datën 21.01.2022.

-KESH sh.a. me shkresën Nr. 2518 prot., datë 26.05.2022 i është drejtuar përsëri shoqërive FSHU sh.a. dhe OSHEE sh.a., për dijeni MIE për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në këtë shkresë KESH sh.a. kërkon shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të dakordësuar nga marrëveshja e mësipërme nga OSHEE sh.a. dhe detyrimet e krijuara nga blerja e energjisë për muajin Mars 2022 nga FSHU sh.a. pjesë e OSHEE Group në vlerën 525 milionë euro.

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 4893 prot., datë 04.10.2022 i është drejtuar OSHEE sh.a. për pagesën e kështit të radhës sipas marrëveshjes, të ndryshuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Me anë të kësaj shkrese KESH sh.a. kërkon nga OSHEE kështin e pagesave për vitin 2022 në shumën prej 16,984,752 euro (me kursin e BSH në atë ditë) dhe vendosjen e kësaj shume si gjendje në llogarinë e posaçme të krijuar sipas marrëveshjes në nenin 2.3-2.7. KESH sh.a. ka kërkuar nga OSHEE sh.a. që kjo pagesë të bëhet brenda datës 6 Tetor 2022, datë në të cilën KESH sh.a. ka detyrimin për shlyerjen e pagesës së kështit për Huan e Ristrukturimin e KESH sh.a. ndaj BERZH. OSHEE Group për periudhën 2021-2022 nuk ka bërë asnjë pagesë për detyrimet e prapambetura ndaj KESH sh.a.

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 1746 prot., datë 29.03.2023 i është drejtuar OSHEE sh.a. për pagesën e kështit të radhës sipas marrëveshjes, të ndryshuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Mbështetur në marrëveshje dhe skedulin e pagesave për vitin 2023 e në vazhdim

pagesa e detyrimit do të bëhet në dy këste 6-mujore, konkretisht në 1 Prill dhe 1 Tetor. KESH sh.a. gjithashtu kërkon që pagesa për këstin e vitit 2023 në shumë prej 16,853,260 euro (bazuar në kursin e këmbimit BSH për atë ditë) të jetë gjendje në llogarinë e posaçme të krijuar sipas nenit 2.3-2.7 të marrëveshjes. KESH sh.a. ka kërkuar që të bëhet vlere e plotë e pagesës brenda datës 1 Prill 2023, pasi kjo është datë në të cilën shoqëria ka detyrim për shlyerjen e pagesës së kështit sipas Huas për Ristrukturimin e KESH sh.a. ndaj BERZH.

-OSHEE Group sh.a. me anë të shkresës Nr.6997 prot., datë 15.10.2024 i është drejtuar KESH sh.a. dhe për dijeni OST sh.a. dhe MIE me një informacion lidhur me pagesat e detyrimeve për disbalancat FLT sh.a.- OST sh.a.

Në këtë informacion OSHEE Group sh.a. shpjegon se për gjatë vitit 2024, në kuadër të marrëveshjes “Për detyrimet e prapambetura” ka paguar 700 milionë lekë detyrime të prapambetura ndaj KESH sh.a., të cilat janë të destinuar për shlyerjen e kredisë që KESH sh.a. ka me MF.

*Në vijim të përmbushjes së detyrimeve, bazuar në Marrëveshjen Nr.208 Rep., Nr.91 Kol., datë 06.04.2018 e ndryshuar “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, nisur nga analizat e përbashkëta të gjendjes financiare dhe propozimet për ecurinë, në diskutimet me pjesëmarrje të përfaqësuesve të MIE ndërmjet tre shoqërive shtetërore të Sektorit Elektroenergjitik OSHEE Group sh.a., OST sh.a., KESH sh.a. është dakordësuar që për pjesën e mbetur të vitit 2024, OSHEE Group sh.a. në kuadër të angazhimit për të asistuar KESH sh.a. në situatën e saj financiare do përpiqet që të paguajë ndaj Shoqërisë OST sh.a. vlerën 240 milionë lekë/muaj për shlyerjen e detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura të disbalancave që shoqëria FTL sh.a. i detyrohet kësaj të fundit.*

OSHEE Group sh.a. do të vazhdojë gjithashtu të paguajë detyrimin sipas marrëveshjes me OST në vlerën 360 milionë lekë në vit, sipas skedulit të pagesave të dakordësuar. Në planet e likuiditetit të OSHEE Group sh.a. është parashikuar që deri në Dhjetor 2024, për detyrimet e përmendura më lart, të paguhen për OST sh.a. afërsisht 310 milion lekë në muaj.

Shoqëria OST sh.a. gjatë diskutimeve të kryera është dakordësuar që të ardhurat nga pagesat për disbalancat, sipas përcaktimit në nenin 7 të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit lidhur ndërmjet këtyre dy shoqërive me Nr. 2120 prot., datë 30.03.2020 për OST sh.a. dhe Nr. 963 prot., datë 30.03.2020 për FTL sh.a./OSHEE Group sh.a. të paguhen menjëherë për shlyerje detyrimesh ndaj KESH sh.a.

Për të gjitha detyrimet e lartpërmendura, referuar edhe shkresës sonë Nr. 5953/1 prot, datë 22.07.2024 “Kthim përgjigje, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve”, shprehim angazhim maksimal të shoqërive të OSHEE Group sh.a. për të përmbushur në kohë shlyerjen e detyrimeve, sikurse është dakordësuar. (shkresa Nr. 5953/1 prot, datë 22.07.2024 nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti).

-KESH sh.a. me anë të shkresës Nr. 5021 prot., datë 08.10.2024 i është drejtuar OSHEE sh.a. mbi shlyerjen e detyrimeve. Sipas skedulit kësti për vitin 2024 është në vlerën 16,725,661 euro ose ekuivalente në monedhën 2,224,512,913 lekë nga të cilat për vitin 2024 janë likuiduar 700,000,000 lekë. KESH sh.a. rikujton OSHEE sh.a. se kësti i parë për vitin 2024 duhet të ishte paguar i plotë deri në 1 Prill 2024, ndërkohë detyrimi vazhdon të jetë i shlyer pjesërisht.

-OSHEE sh.a. me anë të shkresës Nr. 8636/1 prot., datë 16.10.2024 i është drejtuar shoqërisë KESH sh.a. dhe për dijeni OST sh.a. dhe MIE duke i kthyer përgjigje shkresës Nr. 5021 prot., datë 08.10.2024.

Në këtë kthim përgjigje OSHEE sh.a. informon se është sqaruar me shkresën Nr. 6997 prot., të dërguar në datën 15.08.2024 me anë të se cilës ju bëjnë me dije se: *Në vijim të përmbushjes së*

detyrimeve, bazuar në Marrëveshjen Nr.208 Rep., Nr.91 Kol., datë 06.04.2018 e ndryshuar “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, nisur nga analizat e përbashkëta të gjendjes financiare dhe propozimet për ecurinë, në diskutimet me pjesëmarrje të përfaqësuesve të MIE-së ndërmjet tre shoqërive shtetërore të Sektorit Elektroenergjitik OSHEE Group sh.a., OST sh.a., KESH sh.a. është dakordësuar që për pjesën e mbetur të vitit 2024, OSHEE Group sh.a. në kuadër të angazhimit për të asistuar KESH sh.a. në situatën e saj financiare do përpiqet që të paguajë ndaj Shoqërisë OST sh.a. vlerën 240 milionë lekë/muaj për shlyerjen e detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura të disbalancave që shoqëria FTL sh.a. i detyrohet kësaj të fundit.

OSHEE Group sh.a. do të vazhdojë gjithashtu të paguajë detyrimin sipas marrëveshjes me OST në vlerën 360 milionë lekë në vit, sipas skedulit të pagesave të dakordësuar. Në planet e likuiditetit të OSHEE Group sh.a. është parashikuar që deri në Dhjetor 2024, për detyrimet e përmendura më lart, të paguhen për OST sh.a. afërsisht 310 milionë lekë në muaj.

Shoqëria OST sh.a. gjatë diskutimeve të kryera është dakordësuar që të ardhurat nga pagesat për disbalancat, sipas përcaktimit në nenin 7 të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit lidhur ndërmjet këtyre dy shoqërive me Nr. 2120 prot., datë 30.03.2020 për OST sh.a. dhe Nr. 963 prot., datë 30.03.2020 për FTL sh.a./OSHEE Group sh.a. të paguhen menjëherë për shlyerje detyrimesh ndaj KESH sh.a.

#### **Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar:**

Nuk ka asnjë dokumentacion për hapjen e llogarisë Escrow brenda 60 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes midis dy shoqërive KESH-OSHEE. Kjo llogari duhet të hapej në një bankë të nivelit të dytë e dakordësuar midis palëve e cila duhet të jetë aktive dhe të ketë të depozituar këstin vjetor përkatës sipas Aneksit 1 për gjithë kohëzgjatjen e kësaj marrëveshje duke shërbyer si garanci për shoqërinë KESH në lidhje me pagesën e kësteve sipas dakordësimit. Mos hapja e kësaj marrëveshje është në kundërshtim me nenet 2.3-2.7 të marrëveshjes dhe përben arsye për prishjen e marrëveshjes bazuar në nenin 6.2 të marrëveshjes.

Për vitin 2019, KESH sh.a. në lidhje me këtë marrëveshjen, ka bërë njoftim e dytë sipas afateve në marrëveshje për shlyerjen e pjesës së mbetur të pagesës sipas skedulit të pagesës dhe marrëveshjes. Në lidhje me këto dy njoftime OSHEE ka paguar vetëm 9,783,789 euro nga 17,379,228 euro që është pagesa e kështit për vitin 2019. Arsyetimi që OSHEE sh.a. ka bërë për pagesën e vetëm kësaj vlerë nuk ka lidhje me marrëveshjen që këto dy shoqëri kane lidhur, kjo pasi:

Mosfurnizimi nga KESH i sasisë së energjisë së planifikuar sipas programit financiar të miratuar nga MIE për vitin 2019 nuk është pjesë e marrëveshjes “Për detyrimet e prapambetura” dhe nuk përbën shkak për mospagesën e kështit sipas skedulit të pagesave që kanë rënë dakord. Situata e huasë lidhur midis KESH dhe BERZH e lehtëson OSHEE Group nga pagesa e kështit për pjesën e ndryshuar dhe jo për pjesën fikse që kanë rënë dakord në nenin 2 pika 2.1, 2.2, të kësaj marrëveshje. Për vitin 2020, KESH sh.a. në lidhje me marrëveshjen, njoftimin për pagesën e kështit e ka bërë së bashku me njoftimin për detyrimet që FSHU sh.a. ka ndaj KESH sh.a. mbi marrëdhënien tregtare aktuale. KESH sh.a. nuk ka bërë njoftim sipas nenit 2.2. të kësaj marrëveshje për pjesën e pa paguar. OSHEE sh.a. në përgjigje të shkresës që KESH sh.a. i ka dërguar për shlyerjen e kështit të viti pagesën në vlerë prej 7,600,000 euro nga 17,253,359 që është kësti e ka bërë vetëm për pjesën e detyrimit që KESH sh.a. ka ndaj BERZH (EBRD).

Për vitin 2021, KESH sh.a. nuk ka dërguar asnjë njoftim për pagesën e kështit për vitin 2021 dhe nuk ka marrë asnjë masë për njoftim të OSHEE për zbatimin e kësaj marrëveshje. OSHEE nuk ka bërë asnjë pagesë për vitin 2021 duke shkelur këtë marrëveshje dhe vendosur në situatë të vështirë

financiare shoqërinë KESH sh.a. Grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion asnjë shkresë apo kthim përgjigje që OSHEE Group sh.a. ka dërguar për këtë periudhë ndaj KESH sh.a. apo MIE-s si pronar i këtyre dy shoqërive.

Për vitin 2022, KESH sh.a. në lidhje me këtë marrëveshje janë bërë dy njoftime por nga ana e OSHEE nuk është bërë asnjë pagesë. Grupit të auditimit nuk ju vendos në dispozicion asnjë shkresë apo kthim përgjigje që OSHEE Group sh.a. ka dërguar për këtë periudhë ndaj KESH sh.a. apo MIE si pronar i këtyre dy shoqërive.

Për vitin 2023, KESH sh.a. ka bërë vetëm një njoftim për pagesën e kështit të parë në 1 Prill sipas marrëveshjes dhe nuk ka bërë njoftim për pagesën e kështit të dytë në 1 Tetor 2023. OSHEE ka paguar vetëm 1,300,000,000 lekë nga 2,241,483,580 lekë që është kështi. Grupit të auditimit nuk ju vendos në dispozicion asnjë shkresë apo kthim përgjigje që OSHEE Group sh.a. ka dërguar për këtë periudhë ndaj KESH sh.a. apo MIE si pronar i këtyre dy shoqërive.

Për vitin 2024, KESH sh.a. ka bërë vetëm një njoftim për pagesën e kështit të dytë i cili duhet të paguaj në 1 Tetor së bashku me pjesën e ngelur pa paguar në kështin e parë në 1 Prill 2024. OSHEE sh.a. ka paguar vetëm 700,000,000 lekë nga 2,224,512,913 lekë që është kështi.

Deri në Nëntor 2024 pas marrëveshjes së netimit që këto dy shoqëri kanë bërë dhe amendimit të kontratës Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.20218 duke dakordësuar skedulin e ri të pagesave OSHEE ka paguar për vitet 2021-2024 vetëm 2,000,000,000 lekë nga 9,001,428,961 lekë që duhet të paguaj.

**Marrëveshje për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura protokolluar me Nr. 2585 Prot., OST sh.a. dhe Nr. 3881 Prot., OSHEE sh.a. datë 15.04.2021 lidhur midis Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Kreditori) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. (OSHEE ose Debitori).**

Detyrimi i prapambetur, sipas kësaj Marrëveshje është detyrimi deri në vlerën që dy palët Debitori dhe Kreditori kanë dakordësuar deri më 31.12.2020, në vlerën 9,687,768,309 lekë. Nëse kjo vlerë detyrimi do të ndryshojë në të ardhmen me dakordësi midis palëve, vlera e ndryshuar do t'i shtohet apo pakësohet vlerës totale të kësaj Marrëveshje. Palët në këtë marrëveshje kanë rënë dakord që Debitori të paguajë detyrimin e prapambetur në pagesa mujore, duke filluar nga data 01.07.2021 e derisa ky detyrim të shlyhet plotësisht. Detyrimi i prapambetur do të shlyhet sipas një pagese të barabartë me 6.5% të shumës totale të faturës korrente të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike dhe faturës së disbalancave të lëshuara nga Kreditori për FSHU dhe FTL, por jo më pak se 360 milionë lekë në vit deri në shlyerjen e plotë të detyrimit. Debitori në varësi të situatës financiare, mund të kryejë likuidime mbi përqindjen e caktuar deri në shlyerjen e plotë të detyrimit. Nëse vlera e paguar si % mbi faturat mujore është më e vogël se 360 milionë lekë në vit, diferenca paguhet në muajin e fundit të vitit. Debitori për çdo vonesë në kryerjen e pagesave, tej afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje, vlerës së njoftuar të pagesës do ti shtohet automatikisht interesi për vonesën në përputhje me ligjin Nr.48/2014.

Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në momentin e nënshkruar nga të gjitha palët dhe do të përfundojë pasi të jetë paguar plotësisht i gjithë detyrimi i përcaktuar në nenin 1 të kësaj marrëveshje.

**Zbatimi i marrëveshjes OSHEE sh.a. – OST sh.a.**

Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion tabela me pagesat që shoqëria OSHEE sh.a. ka bërë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të marrëveshjes lidhur me Nr. 2585 Prot., OST sh.a. dhe Nr. 3881 Prot., OSHEE sh.a. datë 15.04.2021.

| Assignment | Document Number | Document Date | Document currency | Amount in local currency | Text                                                |
|------------|-----------------|---------------|-------------------|--------------------------|-----------------------------------------------------|
| Kesti 2022 | 1500001262      | 9/20/2022     | ALL               | 90,000,000.00            | Lik det prapamb Nr.3881/15.04.21 Janar-Mars 22-OST  |
| Kesti 2022 | 1500001592      | 11/30/2022    | ALL               | 90,000,000.00            | Lik det prapamb Nr.3881/15.04.21 Prill-Qersh22-OST  |
| OST Sh.a   | 1500000044      | 1/17/2023     | ALL               | 90,000,000.00            | Lik det prapamb Nr.3881/15.04.21 Tet-Dhjet 22-OST   |
| OST Sh.a   | 1500000045      | 1/17/2023     | ALL               | 90,000,000.00            | Lik det prapamb Nr.3881/15.04.21 Korri-Shtat 22-OST |
| OST Sh.a   | 1500001209      | 10/4/2023     | ALL               | 20,000,000.00            | Lik pag sipas marreshj Nr.3881,kest Korri-Gusht23   |
| OST Sh.a   | 1500001009      | 7/10/2024     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik dety prapam 3881 dt15.04.21,kest Nento 23-OST   |
| OST Sh.a   | 1500001115      | 8/15/2024     | ALL               | 60,000,000.00            | Lik dety prapa 3881 dt15.04.21,kest Jan-shk234-OST  |
| OST Sh.a   | 1500000507      | 5/2/2023      | ALL               | 90,000,000.00            | Lik pag sipas marresh te prapam J-M 23 nr 3881-OST  |
| OST Sh.a   | 1500000756      | 5/30/2023     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik detyrim prapametur3881/kesti Prill 2023-OST     |
| OST Sh.a   | 1500000972      | 7/31/2023     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik detyrim prapambetura 3881 ,kesti Maj 23-OST     |
| OST Sh.a   | 1500001098      | 8/28/2023     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik detyrim prapametur3881/kesti Qershor 2023-OST   |
| OST Sh.a   | 1500001245      | 10/4/2023     | ALL               | 40,000,000.00            | Lik sipas marresh 3881,Korri-Gusht 2023-OST         |
| OST Sh.a   | 1500000781      | 5/16/2024     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik detyrim prapambetura 3881,kesti Tetor 23-OST    |
| OST Sh.a   | 1500000871      | 6/10/2024     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik dety prapam 3881 dt15.04.21,kest Nento 23-OST   |
| OST Sh.a   | 1500001215      | 9/10/2024     | ALL               | 60,000,000.00            | Lik dety prapa 3881 dt15.04.21,kest Mar-Pril34-OST  |
| OST Sh.a   | 1500001314      | 10/8/2024     | ALL               | 60,000,000.00            | Lik dety prapa 3881 dt15.04.21,kest Maj-Qers24-OST  |
| Kesti 2023 | 1500000658      | 4/23/2024     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik det prapamb Nr.3881/15.04.21 - OST              |
| Kesti 2021 | 1500000223      | 1/28/2022     | ALL               | 90,000,000.00            | Lik sipas marrve 3881 Kesti Tetor-Dhjetor 2021-OST  |
| Kesti 2021 | 100001272       | 7/30/2021     | ALL               | 30,000,000.00            | Lik sipas marreshjes kesti Korri 2021-OST           |
| Kesti 2021 | 100001270       | 9/13/2021     | ALL               | 58,539,109.18            | Lik sipas marreshjes kesti shtator 2021-OST         |
|            |                 |               |                   | 1,078,539,109.18         |                                                     |

### **Pagesat sipas tabelës të vendosur në dispozicion nga OSHEE Group sh.a.:**

Për vitin 2021 OSHEE Group ka kryer 2 pagesa si më poshtë:

Në datën 30.07.2021 pagesën e kështit të muajit Korrik në vlerën 30,000,000 lekë dhe pagesën e kështit të muajit Shtator në datën 13.09.2021 në vlerën 58,539,109. Nga 6 pagesa që OSHEE duhet të paguante për vitin 2021 sipas marrëveshjes ka kryer vetëm dy pagesa.

Për vitin 2022 OSHEE Group ka kryer 3 pagesa si më poshtë:

Në datën 28.01.2022 pagesën për kështet e muajve Tetor-Dhjetor 2021 në vlerën 90,000,000 lekë.

Në datën 20.09.2022 pagesën për kështet e muajve Janar-Mars 2022 në vlerën 90,000,000 lekë.

Në datën 30.11.2022 pagesën për kështet e muajve Prill-Qershor 2022 në vlerën 90,000,000 lekë.

Për vitin 2023 OSHEE Group ka kryer 8 pagesa ndaj OST sh.a. si më poshtë:

Në datën 17.01.2023 janë kryer dy pagesat e prapambetura për vitin 2022 në vlerën 180,000,000 lekë për kështet e muajve Korrik-Shtator 2022 dhe Tetor-Dhjetor 2022.

Në datën 02.05.2023 janë kryer pagesat për kështet e muajve Janar-Mars 2023 në vlerën 90,000,000 lekë.

Në datën 30.05.2023 është kryer pagesa për kështin e muajit Prill 2023 në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 31.07.2023 është kryer pagesa për kështin e muajit Maj 2023 në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 28.08.2023 është kryer pagesa për kështin Qershor në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 04.10.2023 janë kryer 2 pagesa për kështet e muajve Korrik-Gusht në vlerë totale 60,000,000 lekë.

Për vitin 2024 OSHEE Group ka kryer 7 pagesa deri në Tetor 2024 ndaj OST sh.a. si më poshtë:

Në datën 23.04.2024 është kryer pagesa për kështin e muajit Shtator 2023 në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 16.05.2024 është kryer pagesa për këstin e muajit Tetor 2023 në vlerën 30,000,000 lekë. Në datën 10.06.2024 është kryer pagesa për këstin e muajit Nëntor 2023 në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 10.07.2024 është kryer pagesa për këstin e muajit Dhjetor 2023 në vlerën 30,000,000 lekë.

Në datën 15.08.2023 është kryer pagesa për këstet e muajve Janar-Shkurt 2024 në vlerën 60,000,000 lekë.

Në datën 10.09.2024 është kryer pagesa për këstet e muajve Mars-Prill 2024 në vlerën 60,000,000 lekë. Në datën 08.10.2024 është bërë pagesa për këstet e muajve Maj-Qershor 2024 në vlerën 60,000,000 lekë.

**Për zbatimin e kësaj marrëveshje janë dërguar disa shkresa nga ana e OST sh.a. si më poshtë:**

OST sh.a. me shkresën Nr. 4335 prot., datë 15.08.2023 i është drejtuar OSHEE Group dhe për dijeni MIE dhe MFE me kërkesën për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

MFE me shkresën Nr. 149741/1 prot., datë 22.08.2023 i është drejtuar OSHEE Group dhe për dijeni MIE dhe OST për trajtimin e shkresës të OST sh.a. me Nr. 4335 por., datë 15.08.2023.

MIE me shkresën Nr. 6666/2 prot., datë 01.09.2023 i është drejtuar OSHEE Group dhe për dijeni MFE dhe OST për marrjen e masave nga ana e OSHEE Group për respektimin e marrëveshjes dhe Urdhrit të Përbashkët Nr. 304/2020.

Për të gjitha këto shkresa nuk është vendosur në dispozicion asnjë përgjigje e kthyer nga ana e OSHEE Group.

**Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar:**

Për vitin 2021 OSHEE nuk i ka paguar këstet mujorë për të gjithë vitin ndaj OST sh.a. sipas marrëveshjes. Për 3-mujorin e fundit të vitit 2021 nuk janë kryer pagesat dhe totali i pagesave që janë bërë nga OSHEE për vitin 2021 janë në vlerën 88,539,109 lekë.

Për vitin 2022 nga 12 këste që OSHEE Group duhet të paguante, ka kryer pagesën e vetëm 6 kësteve. OSHEE nuk ka bërë pagesat mujore sipas marrëveshjes. Për 6-mujorin e dytë të vitit 2022 ndaj OST sh.a. nuk është bërë asnjë pagesë në mospërputhje me marrëveshjen që këto dy institucione kanë lidhur. Nga vlera minimale prej 360,000,000 lekë që OSHEE duhet të paguajë në vit ndaj OST ka paguar vetëm 180,000,000 lekë.

Për vitin 2023 OSHEE nuk ka bërë pagesat për këstet e muajve Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetori. Nga vlera minimale prej 360,000,000 lekë që OSHEE duhet të paguaj në vit ndaj OST ka paguar vetëm 240,000,000 lekë.

Për vitin 2024 deri në 31 tetor 2024 OSHEE Group konstatohet se pagesat për muajt Korrik, Gusht dhe Shtator 2024 janë kryer.

Për të gjithë vitet e mësipërme që kur kjo marrëveshje është lidhur pagesat për këstet e kryera nga OSHEE janë bërë në mospërputhje me nenet 2.2- 2.3.3 dhe nenin 4.1 paragrafin 2 të kësaj marrëveshje dhe në mospërputhje me urdhrin e përbashkët Nr. 304 datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Të gjitha veprimet e mësipërme të kryera nga OSHEE Group janë në mospërputhje me nenin 5.2 nen që sjell edhe ndërprerje automatikisht të kësaj marrëveshje për shkak të rasteve shkakore të mësipërme.

OST sh.a. ka vepruar në mospërputhje me nenin 4.1 paragrafi 3 duke mos njoftuar OSHEE Group se vlerës së pagesës mujore sipas nenit 2.2 do ti shtohet automatikisht interes për vonesës në

përputhje me Ligjin Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare” i ndryshuar.

**Marrëveshje për Shlyerje Detyrimesh të Prapambetura lidhur me Nr. 3327 Rep., Nr. 1127 Kol., datë 05.10.2021 midis Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH ose Kreditori) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST ose Debitori).**

Kreditori dhe Debitori kanë hyrë në disa marrëdhënie civile në bazë e për zbatim të parashikimeve të ligjit për sektorin energjistik, akteve rregullatorë në bazë e për zbatim të tij, si dhe në marrëdhënie tregtare sipas vullnetit të palëve për dhënien e shërbimeve ndihmëse dhe mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë. Debitori nuk ka kryer të gjitha pagesat që rrjedhin nga marrëdhëniet ndërmjet palëve për disbalancat e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit të energjisë. Sipas kësaj marrëveshje Debitori merr përsipër shlyerjen e pagesave që rrjedhin nga Faturat e Prapambetura që i detyrohet Kreditorit, sipas skedulit përkatës për shlyerjes (këstet për periudhën 30.10.2021 e në vijim) si referuar në Aneksin 1.

Debitori dhe Kreditori kanë lidhur këtë marrëveshje për detyrimet e prapambetura deri më 30.06.2021 në vlerën neto 1,747,854,166 lekë në përputhjet me afatet dhe kushtet e kësaj marrëveshje si dhe të skedulit të Ripagimit të bashkangjitur. Palët kanë rënë dakord që të gjithë detyrimin ta paguajnë në pagesa mujore referuar Aneksit 1, duke filluar nga data 30.10.2021 derisa ky detyrim të shlyhet plotësisht.

Kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët pranë dhe do të mbarojë në përfundim të afatit që kjo marrëveshje ka parashikuar për vetë ekzistencën e saj.

**Zbatimi i marrëveshjes**

Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion tabela me pagesat që shoqëria OST sh.a. ka bërë sipas Aneksit 1 të marrëveshjes për Shlyerje Detyrimesh të Prapambetura lidhur me Nr. 3327 Rep., Nr. 1127 Kol., datë 05.10.2021.

| Pagesat për marrëveshjen e detyrimeve të prapambetura |            |                |                |
|-------------------------------------------------------|------------|----------------|----------------|
| Data pagesës                                          | Kësti      | Shuma e paguar | Data e pagesës |
| 10/30/2021                                            | 10,000,000 | 10,000,000     | 10/29/2021     |
| 11/30/2021                                            | 10,000,000 |                |                |
| 12/30/2021                                            | 10,000,000 |                |                |
| 1/30/2022                                             | 10,000,000 | 30,000,000     | 1/31/2022      |
| 2/28/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 3/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 4/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 5/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 6/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 7/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 8/30/2022                                             | 10,000,000 | 60,000,000     | 8/29/2022      |
| 9/30/2022                                             | 10,000,000 |                |                |
| 10/30/2022                                            | 10,000,000 | 30,000,000     | 10/13/2022     |
| 11/30/2022                                            | 10,000,000 |                |                |
| 12/30/2022                                            | 10,000,000 | 20,000,000     | 12/13/2022     |
| 1/30/2023                                             | 10,000,000 |                |                |
| 2/28/2023                                             | 10,000,000 | 20,000,000     | 2/14/2023      |
| 3/30/2023                                             | 10,000,000 |                |                |
| 4/30/2023                                             | 10,000,000 | 20,000,000     | 4/20/2023      |

|              |                    |                    |            |
|--------------|--------------------|--------------------|------------|
| 5/30/2023    | 10,000,000         |                    |            |
| 6/30/2023    | 10,000,000         | 20,000,000         | 6/12/2023  |
| 7/30/2023    | 10,000,000         |                    |            |
| 8/30/2023    | 10,000,000         |                    |            |
| 9/30/2023    | 10,000,000         | 30,000,000         | 9/14/2023  |
| 10/30/2023   | 10,000,000         |                    |            |
| 11/30/2023   | 10,000,000         |                    |            |
| 12/30/2023   | 10,000,000         | 30,000,000         | 12/28/2023 |
| 1/30/2024    | 10,000,000         |                    |            |
| 2/29/2024    | 10,000,000         |                    |            |
| 3/30/2024    | 10,000,000         | 20,000,000         | 3/4/2024   |
| 4/30/2024    | 10,000,000         |                    |            |
| 5/30/2024    | 10,000,000         |                    |            |
| 6/30/2024    | 10,000,000         | 10,000,000         | 6/24/2024  |
| 7/30/2024    | 10,000,000         | 10,000,000         | 7/5/2024   |
| 8/30/2024    | 10,000,000         | 40,000,000         | 8/12/2024  |
| 9/30/2024    | 10,000,000         | 10,000,000         | 9/2/2024   |
| 10/30/2024   | 10,000,000         | 10,000,000         | 10/3/2024  |
| <b>TOTAL</b> | <b>370,000,000</b> | <b>370,000,000</b> |            |

**Pagesat sipas tabelës së vendosur në dispozicion nga KESH sh.a.:**

Për vitin 2021, OST sh.a. ka bërë pagesën e kështit të parë në datën 29.10.2021 për muajin Tetor 2021 dhe për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2021 pagesa e kësteve nga ana e OST sh.a. nuk është kryer çdo muaj sipas pikës 2 të marrëveshjes që këto dy shoqëri janë dakordësuar. Për vitin 2021 pagesa që OST sh.a. duhet të kryente ndaj KESH sh.a. nuk është paguar e plotë.

Për vitin 2022, OST sh.a. ka kryer 4 pagesa të ndara si më poshtë:

Në datën 31.01.2022 ka kryer pagesën për muajin Janar 2022 dhe pagesën për dy muajt e prapambetur Nëntor dhe Dhjetor 2021.

Në datën 29.08.2022 ka kryer pagesë në vlerën 60,000,000 lekë përkatësisht për këstet e muajve Shkurt-Korrik 2022.

Në datën 13.10.2022 ka kryer pagesë në vlerën 30,000,000 lekë për këstet e muajve Gusht, Shtator dhe Tetor 2022.

Në datën 13.12.2022 ka kryer pagesë në vlerën 20,000,000 lekë për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2022.

Për vitin 2023, OST sh.a. ka kryer 5 pagesa nga 12 që duhet të kryente sipas marrëveshjes dhe aneksit 1.

Në datën 14.02.2023 ka kryer pagesë në vlerën 20,000,000 lekë për këstet e muajve Janar dhe Shkurt 2023.

Në datën 20.04.2023 ka kryer pagesë në vlerën 20,000,000 lekë për këstet e muajve Mars dhe Prill 2023.

Në datën 12.06.2023 ka kryer pagesë në vlerën 20,000,000 lekë për këstet e muajve Maj dhe Qershor 2023.

Në datën 14.09.2023 ka kryer pagesë në vlerën 30,000,000 lekë për këstet e muajve Korrik, Gusht dhe Shtator 2023.

Në datën 28.12.2023 ka kryer pagesë në vlerën 30,000,000 lekë për këstet e muajve Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2023.

Për vitin 2024, OST sh.a. ka kryer 6 pagesa nga 12 që duhet të kryente sipas marrëveshjes dhe aneksit 1.

Në datën 04.03.2024 është kryer pagesë në vlerë 20,000,000 lekë për këstet e muajve Janar dhe Shkurt 2024.

Në datën 24.06.2024 është kryer pagesë në vlerën 10,000,000 lekë për këstin e muajit Mars 2024.

Në datën 5.07.2024 është kryer pagesë në vlerën 10,000,000 lekë për këstin e muajit Prill 2024.

Në datën 12.08.2024 është kryer pagesë në vlerën 40,000,000 lekë për këstet e muajve Maj, Qershor, Korrik dhe Gusht 2024.

Në datën 02.09.2024 është kryer pagesa në vlerën 10,000,000 lekë për këstin e muajit Shtator.

Në datën 03.10.2024 është kryer pagesë në vlerën 10,000,000 lekë për këstin e muajit Tetor.

### **Për sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar:**

Për këstet e muajve Nëntor dhe Dhjetor 2021, OST sh.a. nuk ka kryer pagesën çdo muaj sipas pikës 2 të marrëveshjes që këto dy shoqëri janë dakordësuar. Për vitin 2021 pagesa që OST sh.a. duhet të kryente ndaj KESH sh.a. nuk është paguar e plotë.

Për vitin 2022 pagesa nuk janë kryer në përputhje me marrëveshjen dhe nenin 2 të saj, por vlera që shoqëria OST sh.a. duhet të paguante për vitin 2022 ndaj KESH sh.a. është paguar e plotë edhe pse pagesat nuk janë bërë çdo muaj sipas marrëveshjes.

Për vitin 2023 pagesa nuk janë kryer në përputhje me marrëveshjen dhe nenin 2 të saj, por vlera që shoqëria OST sh.a. duhet të paguante për vitin 2023 ndaj KESH sh.a. është paguar e plotë edhe pse pagesat nuk janë bërë çdo muaj sipas marrëveshjes. Kjo situatë ka vazhduar edhe për vitin 2024.

Në përgjithësi kjo marrëveshje është zbatuar duke kryer pagesën totale vjetore brenda afateve edhe pse pagesa e kësteve nuk është bërë çdo muaj si këto dy subjekte kanë arritur marrëveshje.

Nga ana e shoqërisë KESH sh.a. nuk është kryer asnjë njoftim për pagesën në kohë të kësteve sipas marrëveshjes.

### **Marrëveshja për huat afatgjata OSHEE-KESH.**

Mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE ndaj KESH për huatë afatgjatë.

Me ndarjen e aktivitetit të KESH sh.a. dhe krijimin e dy shoqërive OST sh.a. dhe OSSH sh.a., më 10 Mars 2009 nënshkruhet “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata”, Nr. 1581 Prot. ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), sot OSHEE sh.a. e cila përmban dhe Aneksin 1, ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara.

Për vitin 2020, rezulton shlyerje detyrimi (principal+interes) në vlerën 9,031,080.59 lekë nga 411,646,121.21 lekë.

Për vitin 2021, rezulton shlyerje detyrimi (principal+interes) në vlerën 0 lekë nga 464,737,470.43 lekë.

Për vitin 2022, rezulton shlyerje detyrimi (principal+interes) në vlerën 0 lekë nga 522,769,214.9 lekë.

Për vitin 2023, rezulton shlyerje detyrimi (principal+interes) në vlerën 0 lekë nga 498,560,629.31 lekë.

-Në zbatim të kuadrit rregullator të tregut të energjisë elektrike dhe në zbatim të Vendimeve të ERE-s, për miratimin e tarifave të energjisë elektrike për mbulimin e disbalancave, humbjeve në

rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dy shoqëritë OST dhe KESH kanë bashkëpunuar në zbatimin me rigorozitet të rregullave dhe vendimeve përkatëse, për të siguruar një furnizim normal dhe brenda gjithë standardeve të energjisë elektrike deri tek konsumatorët fundorë. Si rrjedhojë e këtyre marrëdhënieve, janë krijuar detyrime ndërmjet palëve që kanë të bëjnë me detyrime për energjinë elektrike që nevojitet për mbulimin e disbalancave në furnizimin me energji elektrike, si dhe detyrime për energjinë elektrike që nevojitet nga OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e saj të transmetimit. Në të gjitha këto raste, këto detyrime janë formalizuar me faturat përkatëse për periudhën dhe llojin e detyrimit.

Detyrimi i OST sh.a. deri më 31.12.2023, kundrejt KESH sh.a. për energjinë elektrike të furnizuar e faturuar për mbulimin e disbalancave, humbjeve në rrjetin e transmetimit paraqitet si më poshtë:

| <b>Emërtimi i llogarisë</b>                                   | <b>Viti 2020</b>     | <b>Viti 2021</b>     | <b>Viti 2022</b>     | <b>Viti 2023</b>     |
|---------------------------------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| OST shitje energjie për disbalancat                           | 4,164,097,100        | 4,142,502,480        | 2,244,850,704        | 2,056,717,505        |
| OST për faturat e humbjeve                                    | 43,665               | 454,174,705          | 0                    | 0                    |
| OST shitje energjie për aktivizim rezerve                     | 453,952,950          | 1,682,084,512        | 6,527,258,337        | 7,594,275,877        |
| Shitje për shërbime ndihmëse                                  | 22,667,040           | 313,863,640          | 157,666,448          | 284,000,659          |
| Diference çmimi për humbjet e energjisë të tregtuara në Bursë | 0                    | 0                    | 225,350,423          | 18,532,039           |
| <b>TOTALI</b>                                                 | <b>4,640,760,755</b> | <b>6,592,625,337</b> | <b>9,155,125,912</b> | <b>9,953,526,080</b> |

Në fund të vitit 2023 shoqëria OST sh.a. rezulton debitore ndaj shoqërisë KESH sh.a në vlerën e rreth 9,953,526,080 lekë, shumë që i korrespondon faturave (detyrimeve të pashlyera) për energjinë elektrike, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit si edhe faturave për shërbimet ndihmëse dhe energjisë balancuese. OST ka likuiduar vetëm detyrimet korrente për faturat e humbjeve dhe shërbimeve ndihmëse, por nuk ka vijuar me likuidimet për disbalancat dhe Aktivizimin e rezervës.

Faturat e papranuara nga OST janë fatura penaliteti për mos likuidim në afat të cilat kapin vlerën 1,283,100,142 lekë.

-Në datën 05.10.2021, me Nr. 4859 Prot, mes KESH sh.a. dhe OST sh.a. është nënshkruar Marrëveshja për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 1.747.854.166 lekë për detyrimin e disbalancave. OST e ka respektuar skedulin në përgjithësi skedulin e pagesave të kësaj marrëveshjeje.

-Gjithashtu në zbatim të “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata” nënshkruar më datë 25.05.2009 ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), e cila përmban dhe Aneksin 1, ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara. Detyrimet e mësipërme janë të rakorduara mes të dy shoqërive.

-Me VKM Nr. 171, datë 25.02.2015, “Për Miratimin e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të sektorit të energjisë elektrike” botuar në fletoren zyrtare Nr. 30 Mars 2015, është miratuar plani i masave për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, për disiplinimin financiar të tij. Qëllimi i planit është të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore, si dhe të propozojë një plan të rimëkëmbjes financiare shoqëruar me

një plan veprimi për 5 vitet e ardhshme me mbështetjen e Bankës Botërore. Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.74, datë 27.05.2015 “Për ngritjen e grupit ndër institucional të punës për evidentimin dhe adresimin e problematikave, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, në sektorin e energjisë elektrike”, po ndërmerren hapa për evidentimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat ndërmjet operatorëve të sektorit.

Në zbatim të planit të masave të miratuar më datë 17.12.2020, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili ka rishikuar dhe marrëveshjen mes OSHEE dhe KESH e lidhur në vitin 2018, rezulton se OSHEE nuk ka respektuar kushtet e kësteve për pagesa ndaj KESH.

**OSHEE sh.a. në datën 03.12.2020 për ndarjen e shoqërisë ka bërë 3 marrëveshje me shoqëritë bija me objekt si më poshtë:**

- 1.Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 9215 prot., të OSSH sh.a.
- 2.Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489/1 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 4491 prot., të FTL sh.a.
- 3.Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489/2 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 10984 prot., të FSHU sh.a.

**Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 9215 prot., të OSSH sh.a.**

Kjo marrëveshje e fillon vlefshmërinë e transferimit të aktivitetit nga data 01.01.2020. Sipas nenit 3 të kësaj marrëveshje duke nisur nga data 01.01.2020 OSSH sh.a. do të disponojë lirisht aktivet dhe detyrimet dhe ka detyrimin për të shlyer të gjitha taksat dhe tatimet që i përkasin shoqërisë duke filluar nga kjo datë. Nëse është e nevojshme dhe sipas rastit, “OSHEE Group sh.a.” angazhohet të ndërmarrë e të kryej të gjitha veprimet e domosdoshme për të transferuar autorizimet e licencat në emër të OSSH sh.a. për gjithë sa është çeduar nëpërmjet kësaj Marrëveshje, ku shpenzimet dhe detyrimet përkatëse do të përballohen nga OSSH sh.a.

Shoqëria OSSH sh.a. ka marrë përsipër pjesën e detyrimeve dhe kapitaleve të veta nga ndarja dhe kjo vlerë është e barabartë me aktivet neto të përfituara. Vlera e detyrimeve që do të likuidohen nga OSSH sh.a. është përcaktuar në anekset Nr.5,7 dhe 8 të kësaj marrëveshje.

Aneksi 5 i marrëveshjes midis OSHEE Group dhe OSSH sh.a. ka përmbledhjen e detyrimit ndaj OSHEE (llogari të pagueshme tregtare ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a.) që kanë kaluar pranë shoqërisë OSSH sh.a. nga ndarja.

| Llogaria                              | Përshkrimi               | OSSH                  |
|---------------------------------------|--------------------------|-----------------------|
| 401000                                | Furn. EN. Prodh. Venda   | 26,644,409,133        |
| 401009                                | Diff. rivlerësim KESH    | 1,188,638,206         |
| 401300                                | Blerje energji (import)  | 100,696,694           |
| 401110                                | Furn.Inv.Bl.Asetesh KESH | 10,909,028            |
| <b>Total detyrimi ndaj KESH sh.a.</b> |                          | <b>27,743,259,674</b> |

| Llogaria | Përshkrimi            | OSSH          |
|----------|-----------------------|---------------|
| 407000   | Furn. Trans. EN (OST) | 7,111,282,890 |
| 407100   | Furn. Disb Energji    | 40,465,545    |

|                                      |                          |                      |
|--------------------------------------|--------------------------|----------------------|
| 401009                               | Rivl. Furnitore- ALL OST | 4,337,606            |
| <b>Total detyrimi ndaj OST sh.a.</b> |                          | <b>7,147,410,828</b> |

Aneksi 7 i marrëveshjes përmban detyrimin përmbledhës ndaj OSHEE për kreditë pjesa afatshkurtër e huas afatgjatë të kaluar shoqërisë OSSH sh.a. nga ndarja.

|                                                                                    |                      |
|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Përshkrimi                                                                         | OSSH                 |
| Hua afatgjatë                                                                      | 6,103,459,597        |
| <b>Total detyrimi ndaj OSHEE sh.a. për kreditë afatshkurtër të huasë afatgjatë</b> | <b>6,103,459,597</b> |

Detyrimet e mësipërme rrjedhin nga detyrimi për kreditë afatshkurtër. Këto detyrime nëse pas datës 01.01.2020 e në vazhdim do të lindin penalitete dhe detyrime të tjera shtesë, ato do ti kalojnë shoqërisë OSSH sh.a.

Aneksi 8 i marrëveshjes përmban detyrimin ndaj OSSHE për huan afatgjatë të kaluar shoqërisë OSSH sh.a. nga ndarja.

|                                                              |                       |
|--------------------------------------------------------------|-----------------------|
| Përshkrimi                                                   | OSSH                  |
| Detyrimi ndaj OSHEE sh.a. për kreditë afatgjatë              | 10,137,199,278        |
| <b>Total detyrimi ndaj OSHEE sh.a. për kreditë afatgjatë</b> | <b>10,137,199,278</b> |

Detyrimet e mësipërme rrjedhin nga detyrimi për kreditë afatgjatë. Këto detyrime nëse pas datës 01.01.2020 e në vazhdim do të lindin penalitete dhe detyrime të tjera shtesë, ato do ti kalojnë shoqërisë OSSH sh.a.

**Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489/1 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 4491 prot., të FTL sh.a.**

Kjo marrëveshje e fillon vlefshmërinë e transferimit të aktivitetit nga data 01.01.2020. Sipas nenit 3 duke nisur nga data 01.01.2020, FTL sh.a. do të disponojë lirisht aktivet dhe detyrimet dhe ka detyrimin për të shlyer të gjitha taksat dhe tatimet që i përkasin shoqërisë duke filluar nga kjo datë. Nëse është e nevojshme dhe sipas rastit, “OSHEE Group sh.a.” angazhohet të ndërmarrë e të kryej të gjitha veprimet e domosdoshme për të transferuar autorizimet e licensat në emër të FTL sh.a. për gjithë sa është çeduar nëpërmjet kësaj Marrëveshje, ku shpenzimet dhe detyrimet përkatëse do të përballohen nga FTL sh.a.

Shoqëria FTL sh.a. ka marrë përsipër pjesën e detyrimeve dhe kapitaleve të veta nga ndarja dhe kjo vlerë është e barabartë me aktivet neto të përfituara. Vlera e detyrimeve që do të likuidohen nga FTL sh.a. është përcaktuar në anekset Nr. 5 të kësaj marrëveshje.

Aneksi 5 i marrëveshjes midis OSHEE Group dhe FTL sh.a. ka përmbledhjen e detyrimit ndaj OSHEE (llogari të pagueshme tregtare ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a.) që kanë kaluar pranë shoqërisë FTL sh.a. nga ndarja.

|                                       |                          |                   |
|---------------------------------------|--------------------------|-------------------|
| Llogaria                              | Përshkrimi               | FTL               |
| 401000                                | Furn. EN. Prodh. Venda   | 68,536,565        |
| 401009                                | Diff rivlerësim KESH     | 160,928           |
| 401300                                | Blerje energji (import)  | 1,899,616         |
| 401110                                | Furn.Inv.Bl.Asetesh KESH | 17,434            |
| <b>Total detyrimi ndaj KESH sh.a.</b> |                          | <b>70,292,688</b> |

|          |                       |            |
|----------|-----------------------|------------|
| Llogaria | Përshkrimi            | FTL        |
| 407000   | Furn. Trans. EN (OST) | 11,364,863 |

|                                      |                          |                   |
|--------------------------------------|--------------------------|-------------------|
| 407100                               | Furn. Disb Energji       | 64,670            |
| 401009                               | Rivl. Furnitore- ALL OST | 6,932             |
| <b>Total detyrimi ndaj OST sh.a.</b> |                          | <b>11,422,600</b> |

**Marrëveshja për ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a. nëpërmjet transferimit të aktivitetit me Nr. 12489/2 prot., të OSHEE Group dhe me Nr. 10984 prot., të FSHU sh.a.**

Kjo marrëveshje e fillon vlefshmërinë e transferimit të aktivitetit nga data 01.01.2020. Sipas nenit 3 duke nisur nga data 01.01.2020, FSHU sh.a. do të disponojë lirisht aktivet dhe detyrimet dhe ka detyrimin për të shlyer të gjitha taksat dhe tatimet që i përkasin shoqërisë duke filluar nga kjo datë. Nëse është e nevojshme dhe sipas rastit, “OSHEE Group sh.a.” angazhohet të ndërmarrë e të kryej të gjitha veprimet e domosdoshme për të transferuar autorizimet e licencat në emër të FSHU sh.a. për gjithë sa është çeduar nëpërmjet kësaj Marrëveshje, ku shpenzimet dhe detyrimet përkatëse do të përballohen nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a. ka marrë përsipër pjesën e detyrimeve dhe kapitaleve të veta nga ndarja dhe kjo vlerë është e barabartë me aktivet neto të përfituara. Vlera e detyrimeve që do të likuidohen nga FSHU sh.a. është përcaktuar në anekset Nr. 5 të kësaj marrëveshje.

Aneksi 5 i marrëveshjes midis OSHEE Group dhe FSHU sh.a. ka përmbledhjen e detyrimit ndaj OSHEE (llogari të pagueshme tregtare ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a.) që kanë kaluar pranë shoqërisë FSHU sh.a. nga ndarja.

| Llogaria                              | Përshkrimi               | FSHU                  |
|---------------------------------------|--------------------------|-----------------------|
| 401000                                | Furn. EN. Prodh. Vendas  | 16,138,369,484        |
| 401009                                | Diff rivlerësim KESH     | 37,893,853            |
| 401300                                | Blerje energji (import)  | 447,304,469           |
| 401110                                | Furn.Inv.Bl.Asetesh KESH | 4,105,250             |
| <b>Total detyrimi ndaj KESH sh.a.</b> |                          | <b>16,551,885,350</b> |

| Llogaria                             | Përshkrimi               | FSHU                 |
|--------------------------------------|--------------------------|----------------------|
| 407000                               | Furn. Trans. EN (OST)    | 2,676,094,877        |
| 407100                               | Furn. Disb Energji       | 15,227,862           |
| 401009                               | Rivl. Furnitorë- ALL OST | 1,632,314            |
| <b>Total detyrimi ndaj OST sh.a.</b> |                          | <b>2,689,690,425</b> |

Për sa më sipër grupi i auditimit konstatoi se OSSHE Group sh.a. nuk ka bërë një marrëveshje për ndarjen me këste të detyrimeve që kompanitë bija OSSH sh.a., FSHU sh.a. dhe FTL sh.a. kanë për KESH sh.a. dhe OST sh.a. Mospasja e një marrëveshje për ndarjen me këste të detyrimit respektive që secila kompani ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. ka sjelle edhe mos pagesën e këtyre detyrimeve të plota dhe në kohë duke mos ju përmbajtur marrëveshjes që OSHEE Group ka me KESH sh.a. dhe OST sh.a. Për marrëveshjet që OSHEE Group ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. pagesat janë kryer vetëm nga shoqëria OSSH sh.a. por edhe ato pagesa që janë bërë janë jo të plota dhe në mospërputhje me detyrimin që OSSH sh.a. ka.

## **Plani i masave në reduktimin e detyrimeve të prapambetura në Sektorin e Energjisë Elektrike.**

Me anë të një urdhri të përbashkët nr. 304 datë 17.12.2020, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është miratuar një plan masash për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Ky urdhër propozon një plan veprimi për të parandaluar borxhet e reja ndërmjet kompanive të energjisë elektrike dhe për të forcuar disiplinën e pagesave nga palët e treta. Pas disiplinimit të pagesave korrente, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve të ristrukturimit të borxheve mes kompanive, dhe ku është e mundur, netimin e detyrimeve të ndërsjella për të përshpejtuar procesin e konsolidimit. Ky plan veprimi synon të parandalojë krijimin e detyrimeve të reja të prapambetura ndërmjet kompanive të energjisë elektrike në të njëjtën kohë që siguron një reduktim të qëndrueshëm të stokut të detyrimeve të prapambetura të akumuluar deri në atë periudhë ndërmjet kompanive.

Sipas rakordimit të bërë midis rezultateve të pritshme nga plani i masave të hartuara dhe realizimit të këtij plani për periudhën 2020-30.11.2024, u vu re një mosrealizim i këtij plan veprimi në asnjë vit nga shoqëritë e sektorit energjitik. Mos realizimi i planit të masave ka ardhur për arsye të mos zbatimit të marrëveshjeve për detyrimet e prapambetura si dhe janë krijuar rishtazi detyrime të reja si rezultat i kontratave për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik me energji elektrike dhe shërbimeve të balancimit dhe ribalancimit.

-Për të përballuar gjendjen e vështirë financiare dhe një mungesë të theksuar likuiditetesh KESH ka kërkuar mbështetjen si të buxhetit të shtetit ashtu edhe atë të bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet kredive afat shkurtër (njëvjeçare) si over draft, si dhe për përdorimin e tyre për lëshimin e garancive bankare/letër kredive për kontratat e importit të energjisë.

Shoqëria KESH sh.a. i ka kërkuar MFE-së dhe MIE-së mbështetje buxhetore për veprimtarinë që kjo shoqëri ushtron me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik të ngarkuar. Kjo mbështetje e kërkuar është alokuar për shoqërinë nga ana e MFE-së nëpërmjet një Huaje Buxhetore në vlerën totale 68 milionë euro, në muajin mars 2022. Ndërkohë për përmbushjen e detyrimit sipas VKM Nr. 620/2021 e ndryshuar, KESH sh.a. kishte filluar blerjen e energjisë që në muajin Janar 2022, pa ndryshuar çmimet e shitjes së energjisë në përmbushje të detyrimit për shërbim publik.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, konkretisht neni 3, pika 3, në buxhetin e vitit 2022 është shtuar *“Fondi prej 20,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjitik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat.”*.

OSHEE i detyrohet KESH-it vlerën prej 51,438,460,429 lekë. Ky detyrim përbëhet në 40,853,480,443 lekë për fatura shitjeje energjie elektrike dhe 10,584,979,986 lekë penalitete. Për këtë detyrim shoqëritë kanë lidhur Marrëveshjen për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018. Nga kështet e pagesave të OSHEE, një pjesë ishte për të shlyer Huan e Ristrukturimit të KESH-it ndaj BERZH-it.

Për periudhën 2018-2020, OSHEE ka shlyer për 2018 kështin prej 5.300.000 euro, për vitin 2019 nga 17,379,228 euro vetëm pjesën 9,783,789 euro dhe për vitin 2020 nga 17,253,359 euro kështin është shlyer 7,600,000 euro.

Pretendimi nga OSHEE për mospagesat e plota në 2019-2020 është se KESH nuk e ka furnizuar me energjinë e parashikuar në kontratën për furnizim energjie mes palëve duke e ngarkuar me përgjegjësi për blerjen e energjisë në tregjet e jashtme me çmime më të larta nga sa e ofron KESH. Në datën 28.07.2021 KESH dhe OSHEE kanë nënshkruar një amendim të marrëveshjes me Nr. 1177 Rep., Nr. 569 Kol., me qëllim realizimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018.

Pas amendimit të marrëveshjes KESH i është drejtuar me shkresën Nr. 228 prot., datë 17.01.2022 FSHU-së dhe OSHEE-së për dijeni MIE-së për shlyerjen e detyrimeve financiare. Me anë të kësaj shkrese dhe bazuar në aneksin Nr.1, KESH kërkon nga OSHEE vlerën e kështit për vitin 2021 prej 17,116,244 euro për detyrimet e prapambetura nga FSHU pjesë e OSHEE në vlerën prej 2,441 milionë lekë për periudhën Gusht-Dhjetor 2021. Për shlyerjen e këtyre detyrimeve KESH ka vendosur si afat datën 21.01.2022. KESH ka vijuar me shkresa të tjera duke kërkuar plotësimin e grafikut të pagesave por nga OSHEE nuk ka pasur asnjë përgjigje.

Për periudhën 2021-2024 detyrimi i OSHEE ishte 67,679,917 euro ose 9,001,428,962 lekë, nga këto janë shlyer vetëm 2,000,000,000 lekë dhe diferenca e papaguar është 7,001,428,962 lekë.

Situata e vështirë financiare që ka sjellë rritja e çmimeve të energjisë në fund të vitit 2021 si dhe zhvillimet e konfliktit Rusi-Ukrainë, kanë detyruar KESH që të marrë kredi nga bankat e nivelit të dytë si dhe të financohet nga Buxheti i Shtetit.

Kërkesave të KESH për pagesat e kësteve nga 2021-2023, OSHEE nuk i'u është përgjigjur me argumentime ose arsye të mospagesave.

Mosplotësimi i detyrimeve nga ana e OSHEE për pjesën përkatëse ndaj KESH-it, si dhe situata emergjente ka detyruar Buxhetin e Shtetit të akordojë ndaj KESH-it kredinë 68 milionë euro si shtesë në kapital 20 miliardë lekë.

Për sa i përket huamarrjes publike, gjatë vitit 2022, ka pasur një kërkesë më të ulët për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë në tregun e brendshëm, si rezultat i një niveli pasigurie të lartë në tregje dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit, shkaktuar nga zhvillimet e konfliktit Rusi-Ukrainë. Huamarrja në terma bruto është realizuar në vlerën 386.1 miliardë lekë, nga të cilat 92.7% u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 7.3% nëpërmjet burimeve të huaja.

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, viti 2022 ka qenë një vit jo i zakonshëm, i ndikuar nga zhvillime jo të favorshme në tregjet financiare, ndër të cilat është rritja e normës bazë të interesit brenda vendit nga Banka Qendrore, politikë e cila është ndjekur gjithashtu edhe nga autoritetet ndërkombëtare monetar.

Nga të dhënat e marra nga buletinet e Ministrisë së Financave, kosto mesatare borxhit të brendshëm për vitet 2022-2024, nuk ka qenë asnjëherë më poshtë se 4 %.

Kosto financiare e likuiditeteve që OSHEE i detyrohej KESH-it për të paguar, por që u plotësua nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet instrumenteve të borxhit të brendshëm është në vlerën 635,196,774 lekë. Për sa më sipër, mosveprimet nga OSHEE për shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it, për periudhën 2022-2024, në pjesën e tyre kanë sjellë shpenzime pa efikasitet nga Buxheti i Shtetit, në vlerën 635,196,774 lekë.

**2.3. Vlerësimi i situatës debitore në tërësi, zbatimi i masave të marra për evidentimin, adresimin e problematikave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe efektet e krijuara nga mos realizimi i objektivave të përcaktuara.**

Situata debitore në vite paraqitet si më poshtë:

Situata financiare e KESH

Në 000 lekë

| Nr          | Përshkrimi i të Arkëtueshmeve                                              | Të Arkëtueshme<br>31.12.2020      | Të Arkëtueshme<br>31.12.2021      | Të Arkëtueshme<br>31.12.2022      | Të Arkëtueshme<br>31.12.2023      | Të Arkëtueshme<br>30.11.2024      |
|-------------|----------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| <b>1</b>    | <b>Shuma e Detyrimit të OSHEE sh.a. ndaj KESH sh.a.</b>                    | <b>61,431,968</b>                 | <b>63,803,007</b>                 | <b>67,851,777</b>                 | <b>70,886,204</b>                 | <b>62,295,483</b>                 |
|             | Detyrim ndaj OSHEE Group (Marrevëshja)                                     | 48,890,292                        | 48,910,915                        | 48,910,915                        | 47,610,915                        | 46,910,915                        |
|             | Shitje Energjie FSHU                                                       | -                                 | 2,441,154                         | 6,856,77                          | 11,951,736                        | 4,541,993                         |
|             | Penalitete FSHU                                                            | -                                 | -                                 | 112,441                           | 112,441                           | 112,441                           |
|             | Të arkëtueshme për diferenc cmimi të energjisë (FMF) tregëtuar në Bursë    | -                                 | -                                 | -                                 | 248,91                            | 104,464                           |
|             | Kredi Afatgjatë                                                            | 12,529,428                        | 12,439,849                        | 11,959,582                        | 10,952,443                        | 10,615,919                        |
|             | Penalitete për kreditë                                                     | 12,247                            | 11,087                            | 12,065                            | 9,749                             | 9,749                             |
| <b>2</b>    | <b>Shuma e Detyrimit të OST sh.a. ndaj KESH sh.a.</b>                      | <b>13,760,113</b>                 | <b>15,664,441</b>                 | <b>18,982,446</b>                 | <b>19,390,638</b>                 | <b>18,279,651</b>                 |
|             | Transmetime energji elektrike                                              | 4,618,093                         | 6,278,761                         | 8,772,109                         | 9,650,993                         | 8,907,190                         |
|             | Shërbime ndihmëse OST                                                      | 22,667                            | 313,863                           | 157,666                           | 284,000                           | 224,089                           |
|             | Të arkëtueshme për diferenc cmimi të energjisë (Humbje) tregëtuar në Bursë | -                                 | -                                 | -                                 | 18,532,039                        | 56,458                            |
|             | Penalitete për moslikujdim fature (te papranuara nga OST)                  | 3,728                             | 3,728                             | 1,283,100                         | 1,283,100                         | 1,283,100                         |
|             | Kredi Afatgjatë                                                            | 9,113,840                         | 9,065,874                         | 8,767,049                         | 8,151,477                         | 7,862,680                         |
|             | Penalitete për kreditë                                                     | 1,783                             | 2,212                             | 2,521                             | 2,534                             | 2,534                             |
|             |                                                                            |                                   |                                   |                                   |                                   |                                   |
| <b>Nr .</b> | <b>Përshkrimi i detyrimit</b>                                              | <b>Detyrimi më<br/>31.12.2020</b> | <b>Detyrimi më<br/>31.12.2021</b> | <b>Detyrimi më<br/>31.12.2022</b> | <b>Detyrimi më<br/>31.12.2023</b> | <b>Detyrimi më<br/>30.11.2024</b> |
| <b>1</b>    | <b>Furnitorë të tjerë</b>                                                  | <b>7,433,629</b>                  | <b>1,099,958</b>                  | <b>940,019</b>                    | <b>736,823</b>                    | <b>818,479</b>                    |
|             | Për fatura të pranuar                                                      | 7,433,629                         | 1,099,958                         | 940,019                           | 736,823                           | 818,479                           |
| <b>2</b>    | <b>Furnitorë për energji</b>                                               | <b>8,744</b>                      | <b>629,304</b>                    | <b>9,439,776</b>                  | <b>10,989,819</b>                 | <b>10,989,819</b>                 |
|             | Për fatura të pranuar                                                      | 8,744                             | 629,304                           | 5,458,432                         | 1,023,429                         | 3,325,982                         |
|             | Furnizuesi I Tregut te Lire                                                | -                                 | -                                 | 3,981,344                         | 9,966,390                         | 0                                 |
| <b>3</b>    | <b>Kredi Banka Botërore (Hua Afatgjatë IBRD Pr. RE) etj.</b>               | <b>67,574,335</b>                 | <b>66,792,135</b>                 | <b>63,929,574</b>                 | <b>58,689,397</b>                 | <b>62,365,209</b>                 |
| <b>4</b>    | <b>Hua Ministria e Financave</b>                                           | <b>31,470,380</b>                 | <b>34,221,164</b>                 | <b>45,884,750</b>                 | <b>47,168,113</b>                 | <b>57,414,872</b>                 |
|             | Hua Afatgjatë Ministria e Financave                                        | 6,258,400                         | 6,241,167                         | 13,631,650                        | 12,715,449                        | 20,078,823                        |
|             | Hua Afatshkurtër Ministria e Financave                                     | 24,681,098                        | 27,841,754                        | 32,160,654                        | 34,260,439                        | 37,143,824                        |
|             | Penalitete për Huate                                                       | 530,881                           | 138,242                           | 92,444                            | 192,224                           | 192,224                           |
| <b>5</b>    | <b>OVD</b>                                                                 | <b>7,311,795</b>                  | <b>4,974,130</b>                  | <b>5,276,022</b>                  | <b>922,070</b>                    | <b>0</b>                          |
| <b>6</b>    | <b>Detyrime ndaj Tatimeve</b>                                              | <b>522,292</b>                    | <b>12,317</b>                     | <b>-</b>                          | <b>-</b>                          | <b>0</b>                          |
|             | <b>TOTAL</b>                                                               | <b>46,746,842</b>                 | <b>40,936,876</b>                 | <b>61,540,568</b>                 | <b>59,816,826</b>                 | <b>69,223,171</b>                 |

Situata financiare e OSHEE

Në 000 lekë

| Nr           | Përshkrimi i detyrimit                                          | Detyrimet<br>31.12.2020<br>më | Detyrimet<br>31.12.2021<br>më | Detyrimet<br>31.12.2022<br>më | Detyrimet<br>31.12.2023<br>më |
|--------------|-----------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| <b>1</b>     | <b>Shuma e Detyrimit ndaj KESH sh.a.</b>                        | <b>67,974,892</b>             | <b>61,355,326</b>             | <b>65,739,555</b>             | <b>68,596,510</b>             |
|              | Detyrim për transferim Asete KESH                               | 17,400                        | -                             | -                             | -                             |
|              | Për energjinë elektrike                                         | 57,727,354                    | 2,441,155                     | 6,782,772                     | 12,200,655                    |
|              | Për energjinë elektrike (fatura të papranuara)                  | -                             | -                             | -                             | -                             |
|              | Per fatura të pa ardhura                                        | 95,651                        | -                             | 599,837                       | 426,012                       |
|              | Kredi Afatgjatë                                                 | 10,134,486                    | 10,003,256                    | 9,446,031                     | 8,358,928                     |
|              | Detyrim AfGjate KESH                                            | -                             | 48,910,915                    | 48,910,915                    | 47,610,915                    |
| <b>2</b>     | <b>Shuma e Detyrimit ndaj OST sh.a.</b>                         | <b>11,447,841</b>             | <b>14,346,956</b>             | <b>15,281,810</b>             | <b>15,778,598</b>             |
|              | Transmetime energji elektrike                                   | 11,447,841                    | 3,449,519                     | 5,940,095                     | 6,868,170                     |
|              | Transmetime energji elektrike (fatura të papranuar)             | -                             | -                             | -                             | 1,198                         |
|              | Penalitete për moslikujdim fature                               |                               |                               |                               |                               |
|              | Per fatura të pa ardhura disbalanca                             |                               | 1,298,208                     | 12,486                        |                               |
|              | Detyrim AfGjate OST                                             | -                             | 9,599,229                     | 9,329,229                     | 8,909,229                     |
| <b>3</b>     | <b>Furnitorë për energji HEC</b>                                | <b>1,367,334</b>              | <b>2,747,887</b>              | <b>3,784,976</b>              | <b>4,948,246</b>              |
|              | Për fatura të pranuar                                           | 1,307,503                     | 2,673,306                     | 3,601,042                     | 4,839,894                     |
|              | Per fatura të pa ardhura                                        | 59,831                        | 74,582                        | 183,934                       | 108,351                       |
| <b>4</b>     | <b>Furnitorë për import energjie</b>                            | <b>9,492,608</b>              | <b>13,583,109</b>             | <b>280,895</b>                | <b>76,403</b>                 |
|              | Për fatura të pranuar                                           | 8,356,864                     | 13,583,109                    | 280,895                       | 76,403                        |
|              | Per fatura të pa ardhura                                        | 1,135,743                     | -                             | -                             | -                             |
| <b>5</b>     | <b>Detyrim ndaj CEZ AS (Marrëveshja)</b>                        | <b>-</b>                      | <b>-</b>                      | <b>-</b>                      | <b>-</b>                      |
| <b>6</b>     | <b>Kredi Banka Botërore (Hua Afatgjatë IBRD Pr. RE)</b>         | <b>5,120,775</b>              | <b>4,830,506</b>              | <b>5,488,936</b>              | <b>5,082,348</b>              |
| <b>7</b>     | <b>Kredi afgjate Banka Evropiane per Rind e Zhvillim (EBRD)</b> | <b>-</b>                      | <b>66,418</b>                 | <b>5,514,453</b>              | <b>3,582,005</b>              |
| <b>8</b>     | <b>Kredi afgjate KfW (Frankfurt am Main)</b>                    | <b>-</b>                      | <b>12,614</b>                 | <b>67,616</b>                 | <b>-</b>                      |
| <b>9</b>     | <b>Hua Ministria e Financave</b>                                | <b>2,593,797</b>              | <b>2,640,446</b>              | <b>2,687,240</b>              | <b>2,734,316</b>              |
|              | Hua Afatgjatë Ministria e Financave Nr.14394                    | -                             | -                             | -                             | -                             |
|              | Pjesa afatshkurter e Huase MF Nr.14394                          | 1,550,598                     | 1,578,346                     | 1,606,179                     | 1,634,169                     |
|              | Hua Afatshkurtër Ministria e Financave Nr.14394.1               | 1,043,199                     | 1,062,100                     | 1,081,061                     | 1,100,147                     |
| <b>10</b>    | <b>OVD</b>                                                      | <b>8,200,384</b>              | <b>16,070,816</b>             | <b>17,417,392</b>             | <b>442,306</b>                |
| <b>11</b>    | <b>Shuma e Detyrimit ndaj Posta Shqiptare sh.a.</b>             | <b>183,798</b>                | <b>277,513</b>                | <b>337,587</b>                | <b>337,587</b>                |
|              | Posta - Detyrim për Fatura të pranuar                           | 183,798                       | 418,816                       | 337,429                       | 78,197                        |
|              | Posta -Fatura të Përllogaritura                                 | -                             | -                             | -                             | -                             |
| <b>12</b>    | <b>Detyrime të tjera</b>                                        | <b>12,367,180</b>             | <b>20,151,827</b>             | <b>23,346,683</b>             | <b>32,396,078</b>             |
| <b>13</b>    | <b>Detyrime ndaj Tatimeve</b>                                   | <b>7,022,255</b>              | <b>7,328,865</b>              | <b>5,887,517</b>              | <b>5,959,000</b>              |
| <b>TOTAL</b> |                                                                 | <b>125,770,863</b>            | <b>143,412,283</b>            | <b>145,834,659</b>            | <b>139,933,395</b>            |

Periudha 2020-2023, është shoqëruar me rritje të detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar të OSHEE-së dhe KESH-it.

Në tre shoqëritë e sistemit energjistik, FSHU, pjesë e OSHEE Group, ka përgjegjësinë në mbledhjen e likuiditeteve nga konsumatorët finalë. Pjesa e likuiditeteve më pas është shpërndarë në shpenzime operative, investime dhe pagesat e llogarive të pagueshme ku pjesë janë dhe detyrimet ndaj KESH-it dhe OST-së.

Grupi i auditimit analizoi ecurinë e faturimeve dhe arkëtimeve për periudhën 2020-2023 në OSHEE Grup.

**Arkëtime**      **Faturime**  
**GJITHSEJ**

**VITI 2020**

| Kategoria    | Faturimi              | Arketimi              | Diferenca            | % e Arkëtimit |
|--------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|---------------|
| Buxhetor     | 3,879,875,198         | 3,355,751,628         | 524,123,570          | 86.49%        |
| Familjare    | 33,819,656,165        | 33,821,915,516        | (2,259,351)          | 100.01%       |
| Jo-Buxhetore | 5,024,744,379         | 2,247,057,104         | 2,777,687,275        | 44.72%        |
| Privat       | 23,231,646,454        | 23,028,758,408        | 202,888,046          | 99.13%        |
| <b>Total</b> | <b>65,955,922,196</b> | <b>62,453,482,656</b> | <b>3,502,439,540</b> | <b>94.69%</b> |

**Arkëtime**      **Faturime**  
**GJITHSEJ**

**VITI 2021**

| Kategoria    | Faturimi              | Arketimi              | Diferenca            | % e Arkëtimit |
|--------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|---------------|
| Buxhetor     | 4,265,797,728         | 3,640,306,756         | 625,490,972          | 85.34%        |
| Familjare    | 35,453,865,641        | 35,646,299,570        | (192,433,929)        | 100.54%       |
| Jo-Buxhetore | 5,565,221,648         | 3,425,418,444         | 2,139,803,204        | 61.55%        |
| Privat       | 26,395,960,361        | 26,161,554,140        | 234,406,221          | 99.11%        |
| <b>Total</b> | <b>71,680,845,378</b> | <b>68,873,578,909</b> | <b>2,807,266,469</b> | <b>96.08%</b> |

**Arkëtim Faturime GJITHSEJ**

**VITI 2022**

| Kategoria    | Faturimi              | Arketimi              | Diferenca            | % e Arkëtimit |
|--------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|---------------|
| Buxhetor     | 4,536,781,732         | 4,294,837,962         | 241,943,771          | 94.67%        |
| Familjare    | 36,247,847,128        | 36,521,866,578        | (274,019,449)        | 100.76%       |
| Jo-Buxhetore | 8,294,571,489         | 5,593,058,726         | 2,701,512,762        | 67.43%        |
| Privat       | 33,780,648,426        | 33,426,325,673        | 354,322,753          | 98.95%        |
| <b>Total</b> | <b>82,859,848,774</b> | <b>79,836,088,938</b> | <b>3,023,759,836</b> | <b>96.35%</b> |

**Arkëtim Faturime GJITHSEJ**

**VITI 2023**


| Kategoria | Faturimi       | Arketimi       | Diferenca   | % e Arkëtimit |
|-----------|----------------|----------------|-------------|---------------|
| Buxhetor  | 4,231,916,908  | 4,130,816,289  | 101,100,619 | 97.61%        |
| Familjare | 35,748,185,307 | 35,709,484,991 | 38,700,317  | 99.89%        |

|              |                       |                       |                      |               |
|--------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|---------------|
| Jo-Buxhetore | 6,387,984,104         | 5,199,982,993         | 1,188,001,110        | 81.40%        |
| Privat       | 34,529,201,175        | 34,314,356,605        | 214,844,570          | 99.38%        |
| <b>Total</b> | <b>80,897,287,494</b> | <b>79,354,640,878</b> | <b>1,542,646,616</b> | <b>98.09%</b> |

#### Arkëtim Faturime GJITHSEJ

9-mujori Vitit 2024

| Kategoria    | Faturimi              | Arkëtimi              | Diferenca            | % e Arkëtitimit |
|--------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------|
| Buxhetor     | 3,287,575,211         | 2,687,347,144         | 600,228,067          | 81.74%          |
| Familjare    | 33,212,889,781        | 30,135,594,229        | 3,077,295,552        | 90.73%          |
| Jo-Buxhetore | 4,758,308,537         | 3,377,608,019         | 1,380,700,518        | 70.98%          |
| Privat       | 23,757,448,838        | 21,487,012,419        | 2,270,436,418        | 90.44%          |
| <b>Total</b> | <b>65,016,222,367</b> | <b>57,687,561,811</b> | <b>7,328,660,556</b> | <b>88.73%</b>   |



Në zbatim të urdhrit Nr.114, datë 26.09.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e detyrimeve të ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE Group sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., AKUM dhe Institucioneve Publike” është ngritur grupi i punës me përbërjen si vijon:

- Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE – Kryetar;
- Drejtor i Departamentit të Administrimit të Përgjithshëm në shoqërinë KESH sh.a. – anëtar;
- Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në shoqërinë KESH sh.a. – anëtar;
- Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në shoqërinë OST sh.a. – anëtar;
- Drejtor i Departamentit Ekonomik në shoqërinë OSHEE Group sh.a. – anëtar;
- Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKUM – anëtar.

Ky grup ka zhvilluar analizën e detyrimeve të ndërsjella në sektorin e energjisë ndërmjet shoqërive të sektorit, por nuk ka konkluduar me raportin në lidhje me analizën e detyrimeve të ndërsjella në sektorin e energjisë dhe propozimet përkatëse për zgjidhjen e situatës.

Reforma e sektorit të energjisë e cila filloi në vitin 2014, ka pasur në synim të saj përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe arritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria financiare varet nga shumë faktorë, por kryerja në kohë e pagesave të përdoruesve fundor, qofshin ata privatë apo publikë, dhe kompanive është thelbësore.

Ndër veprimet e ndërmarra në kuadër të reformës dhe planit të rimëkëmbjes së sektorit të energjisë elektrike, ishte edhe ai i ristrukturimit të detyrimeve ndërmjet shoqërive në sektor, nën kuadrin e shlyerjes së rregullt të detyrimeve nga ana e konsumatorëve.

Për të përballuar gjendjen e vështirë financiare dhe një mungesë të theksuar likuiditetesh, KESH sh.a, ka kërkuar mbështetjen si të buxhetit të shtetit ashtu edhe atë të bankave të nivelit të dytë, që operojnë në vendin tonë, nëpërmjet kredive afatshkurtra (njëvjëçare) si overdraft, si dhe për përdorimin e tyre për lëshimin e garancive bankare/letër kredive për kontratat e importit të energjisë. Gjithashtu dhe OST sh.a., ka pasur kufizime në investimet në linjat e transmetimit duke mos rritur parametrat e performancës.

Moskorrektësia e pagesave ndërmjet shoqërive në sistem ka sjellë akumulimin e penaliteteve e shoqëruar me faturat përkatëse, duke sjellë rritje të detyrimeve, mosmarrëveshje mes palëve dhe jodakordësi për situatën financiare dhe përkeqësim të saj jo të justifikuar.

Detyrimet e akumuluar ndër vite në shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike, kanë ndikuar negativisht në të gjithë sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht në aktivitetin ekonomik të secilës shoqëri pjesëmarrëse në këtë sektor. Pasojat kanë qenë të shumta, si rritja e kostove të shërbimit, mungesë e realizimit të investimeve në nivelin e duhur, humbje në energji, uljen e aftësisë paguese të tyre, marrjen e huave për mbulimin e një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve, duke përkeqësuar kështu performancën e tyre.

Performanca e ulur e sistemit energjitik është e lidhur dhe me situata të tjera si emergjenca botërore e rritjes së çmimeve, kushtet klimaterike të thata që bëjnë që energjia të importohet me çmime më të larta se sa prodhimi në vend, duke ndikuar në rritjen e kostos së shërbimit gjë e cila reflektohet në shoqërinë KESH sh.a., e cila ka detyrimin për furnizimin e energjisë në sistem.

Si rezultat janë akumuluar detyrime të reja mes kompanive. Detyrimet e prapambetura nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujit, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura dhe parashikueshmëria e të ardhurave janë penguar, duke krijuar vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit në sektor.

Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor.

Përmirësimi i aftësisë paguese të sektorit të energjisë elektrike është një problem shumë i rëndësishëm.

Si konkluzion konstatohet se në shoqëritë e sistemit energjitik është e nevojshme të konsolidohen pozicionet financiare për mosrakordimet mes palëve, ndalimin e akumulimit të detyrimeve të ndërsjella, krijimin e mekanizmave të monitorimit të performancës në sistemin e shpërndarjes, faturimit dhe mbledhjes së pagesave në sektorët problematikë (institucionet buxhetore dhe ujësjellësit), aplikimin e politikave të garancive dhe mekanizmave të brendshëm për të siguruar pagesën nga entet buxhetore të detyrimeve për furnizim me energji elektrike dhe mundësitë e pagesës nga Buxheti i Shtetit i këtyre detyrimeve por me garancinë që do të qarkullojnë në të gjitha

shoqëritë e sistemit energjistik për të realizuar mbylljen e detyrimeve. Ministria e Financës ose Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës merr përsipër të kryejë pagesë për detyrimet e institucioneve buxhetore dhe ujësjellësat duke u garantuar që këto pagesa kalojnë nga FSHU sh.a. te OSSH sh.a. ose OSHEE sh.a. e cila mbyll detyrimin që ka ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. së pagesave për sektorin buxhetor në tërësi dhe të sektorit të Ujit në veçanti në periudhën vijuese.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1076/6, datë 25.02.2025 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga z. E. E., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me rekomandimin nr.1, pretendohet se KESH rakordon periodikisht detyrimet mes palëve.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë pasi referenca i bëhet përfaqësuesit juridik të shoqërisë (administratorit) i cili ka kompetencën të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me palët e tjera.

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me rekomandimin 3.2 sqarohet se është ngritur grupi i punës në zbatim të Urdhrit nr.114, datë 26.09.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e detyrimeve të ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE Group sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., AKUM dhe Institucioneve Publike”. Ky grup ka vijuar punën për evidentimin e detyrimeve të ndërsjella midis palëve si dhe ka propozuar mënyrën për përmirësimin e situatës financiare me përfshirjen e strukturave eprorë.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me pretendimin e subjektit sqarojmë se nuk janë vënë në dispozicion dokumente të grupit të punës si relacione, proces verbale ose urdhra pune.

**2.4, Të ndryshme të dala gjatë auditimit**

Pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit është depozituar ankesa me Nr.1144 prot., datë 23.09.2024. e bërë nga Z. T.K. Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH) në lidhje me mosrinovimin e kontratës kolektive të OSHEE Group me Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH).

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar informacion në lidhje me ankesën e z. T. K. për moslidhjen e kontratës kolektive.

KLSH-së i janë vendosur në dispozicion dokumentacionet dhe korrespondenca nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ligjore;

1- Kontrata kolektive e punës FSIPSH me OSHEE Group;

2- Statuti i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë;

3- Vendimi i Presidencës Ekzekutive të KSSH;

4- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të KSSH;

5- Vendimi i Kongresit të Jashtëzakonshëm të FSPISH;

6- Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë;

7- Kërkesë për nënshkrimin e kontratës kolektive drejtuar Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë Ligjore të OSHEE Group;

- 8- Kërkesë për lidhje kontrate kolektive nga OSHEE Group për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- 9- Kthim përgjigje nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- 10- Njoftim për takim (OSHEE Group, z.T.K. dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore);
- 11- Autorizim Inspektimit nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për OSHEE Group;
- 12- Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Zyra e Regjistrimit të OJF-ve;
- 13- Vendimi përfundimtar i inspektimit të Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për OSHEE Group;
- 14- Shkresa e vënies në dispozicion e gjendjes aktuale të Federatës Sindikatave e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë etj.

Z. K. i është drejtuar KLSH-së me shkresën Nr.77 prot., datë 20.09.2024 (protokolluar në KLSH me Nr.1144 prot., datë 23.09.2024) ku shpreh shqetësimin për moslidhjen e Kontratës Kolektive me OSHEE Group.

- FSIPSH dhe OSHEE Group kanë lidhur kontratën me Nr. 22326 prot., në 1 Nëntor 2019 për një afat 4 vjeçar dhe ka përfunduar në 1 Nëntor 2023. Kjo kontratë është lidhur midis FSIPSH përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. K. dhe OSHEE Group përfaqësuar nga administratori z. A.C.  
FSIPSH është pjesë e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) që kur kjo Konfederatë është krijuar.
- Presidenca Ekzekutive (PE) e KSSH-së është mbledhur në datën 24.06.2022 ku pas shkeljeve që ka konstatuar në mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit të FSPISH-së ka vendosur: Pezullimin dhe lirin nga të gjitha funksionet sindikale, në mënyrë të menjëhershme të Sekretarit të Përgjithshëm të FSPISH-së, z. K. si person me përgjegjësi direkte për situatën e krijuar. Vënien në lëvizje të Komisionit të Statutit dhe Gjykimit Disiplinor dhe të Komisionit të Financës dhe Auditit të KSSH-së, për të analizuar problematikat e krijuara dhe për të propozuar vendimmarrjen për përgjegjësit konkrete. Caktimin e një eksperti kontabël të licencuar për revizionimin e të gjitha llogarive të FSPISH-së.  
Riorganizim të pjesshëm të strukturave drejtuese të FSPISH-së, duke zhvilluar Kongresin e Jashtëzakonshëm të kësaj federate, nën organizimin dhe vendimmarrjen e KSSH-së, me objekt “Rizgjedhja dhe plotësimi i vakancave për Sekretarin e Përgjithshëm të FSPISH-së, Komisionin e Statutit dhe Disiplinës, Komisionin e Financës dhe Auditit, Koordinatorin e Rrjetit të Rinisë, Koordinatorin e Rrjetit të Gruas, rikompozimin e Asamblesë së Përgjithshme të FSPISH-së sipas përfaqësuesit sindikal dhe normave statutoe”.  
Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së të zhvillohet në datën 20.07.2022.
- Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë me shkresën Nr. 2071 prot., datë 14.07.2022 ka nxjerrë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të F.S.P.I.SH.  
Asambleja e Përgjithshme e FSPISH ka vendosur:  
1-Largimin e FSPISH nga anëtarësimi në Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) në mënyrë të menjëhershme.  
2-Thërritjen e Kongresit të Jashtëzakonshëm të FSPISH në muajin Shtator 2022 me objekt ndryshimin e Statutit të FSPISH-së.

3-Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH-së për vënien në dijeni me shkrim të KSSH për këtë vendim, si dhe strukturat organizative të Kongresit për marrjen e masave për përcaktimin e datës, orës dhe vendit ku do zhvillohet Kongresi, si dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme.

4-Ky vendim përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta, nga të cilat njëra qëndron në ruajtje pranë noteres M. Sh., një kopje do të paraqitet për depozitim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kopje do të përcillet për dijeni KSSH-së dhe një kopje do të qëndrojë në Arkivën e FSPISH-së.

Kjo Asamble e Përgjithshme është mbledhur nga z. K. pas vendimit të Konfederatës në datën 24.06.2022.

**Ky vendim është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë Rrethi Tiranë për tu regjistruar në regjistrin e sindikatës në datën 18.07.2022. Për këtë vendim është shprehur kjo Gjykatë me vendimin Nr.14 datë 27.10.2022 duke e rrëzuar si kërkesë dhe ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 07.12.2022.**

- Në datën 20.07.2022 është mbledhur Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së. Kjo Asamble ka vendosur:

1- Pezullimin dhe lirimimin nga të gjitha funksionet sindikale, në mënyrë të menjëhershme të Sekretarit të Përgjithshëm të FSPISH-së, z. K.

2- Riorganizim të pjesshëm të strukturave drejtuese të FSPISH-së, duke zhvilluar Kongresin e Jashtëzakonshëm të kësaj federate, nën organizimin dhe vendimmarrjen e KSSH-së, me objekt “Rizgjedhja dhe plotësimi i vakancave për Sekretarin e Përgjithshëm të FSPISH-së, Komisionin e Statutit dhe Disiplinës, Komisionin e Financës dhe Auditit, Koordinatorin e Rrjetit të Rinisë, Koordinatorin e Rrjetit të Gruas”

3- Ngarkohet Presidenca Ekzekutive e KSSH-së, Koordinatorët Rajonalë të KSSH-së, Departamenti i Organizimit dhe Departamenti Juridik i KSSH-së, për të riorganizuar pjesërisht strukturat (aty ku mungojnë), zgjedhur delegatët nga struktura e FSPISH për në Kongresin e Jashtëzakonshëm të saj, i cili sipas Statutit duhet të jetë mbledhur deri në fillim të muajit Shtator 2022, si dhe plotësimin e vakancave në strukturat organizative të kësaj Federate dhe duke miratuar ato në Asamblesë të KSSH-së (Neni 18 i Statutit të FSPISH) brenda datës 20 Gusht 2022. Kompetence të cilën Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së ia delegon Presidencës Ekzekutive të KSSH-së.

4- Ngarkohet Presidenca Ekzekutive e KSSH-së që në bashkëpunim me pjesët e mbetura të strukturës organizative të FSPISH, duke filluar nga dita e vendimit të kryej të gjitha procedurat statutoe dhe ligjore, me zyrat e tatim taksave për mbylljen e NIPT L82121451N të FSPISH, si dhe bllokimin e çdo transaksioni që mund të kryhet nga dita e sotme dhe në vazhdim në llogarinë bankare në B.K.T., Dega Nr.1, Tiranë me emërtesë Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë. Bllokimin e të gjitha dokumentacionit zyrtar, si dhe inventarit fizik të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të FSPISH-së apo të KSSH-së në përdorim nga FSPISH. Të gjitha këto do të inventarizohen dhe do të kalojnë në përdorim të stafit të ri që do të zgjedhe Kongresi i Jashtëzakonshëm i FSPISH.

5- Ky vendim pasi u miratua me më shumë se 3/5 e votave të Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, hyn në fuqi menjëherë.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), me anë të kërkesës z. K. N., depozitoj Vendimin dt. 20.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të KSSH në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë bazuar në aktin me Nr.1004, Dt. Regj. 22.07.2022.

Në vendimin “Për depozitim në regjistrin e sindikatës” Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Tiranë, vendosi;

-Pranimin e kërkesës.

-Depozitim i Vendimit dt. 20.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Konfederatave të Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.

-Urdhërohet Zyra e Regjistrimit e Organizatave Fitimprurëse për pasqyrimin e ndryshimeve në kolonat përkatëse të regjistrimit.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk u ankimua me datën 30.01.2023.**

Në datë 07.08.2022 është mbledhur Kongresi i Jashtëzakonshëm i FSPISH-së.

Kongresi i Jashtëzakonshëm i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH), i mbledhur sot më datë 07.08.2022, në Tiranë, me kërkesën e AP së KSSH dhe organizuar nga KSSH vendosi:

- 1- Të miratojë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së, të datës 20.07.2022, duke liruar dhe larguar përfundimisht nga të gjitha funksionet sindikale në KSSH, FSPISH dhe çdo komision, bord apo këshill ku ai është përfaqësues i FSPISH-së apo KSSH-së z. K.
- 2- Kongresi i Jashtëzakonshëm i FSPISH i quan jo legjitime dhe në kundërshtim të plotë me Statutin e FSPISH, mbledhjen e quajtur “Mbledhje e Jashtëzakonshme e AP FSHIPSH-së, të datës 14.07.2022 dhe të ashtu quajturin “Kongres i Jashtëzakonshëm i FSPISH-së” të datës 04.08.2022, duke i konsideruar iniciativa personale të ish-drejtuesit dhe pas asnjë referencë statusore apo hapësirë të mundshme ligjore. Këto veprime të njëanshme dhe antistatuore nuk sjellin asnjë pasojë për gjendjen organizative dhe juridiko-ligjore të FSPISH-së.
- 3- Zgjedhjen e z. K. I. në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të FSPISH-së, funksion i cili sipas Statutit mandate i tij shtrihet me afatin kohor deri në kongresin e zakonshëm të FSPISH-së (Nëntor 2024).
- 4- Riorganizimin e Asamblesë së Përgjithshme të FSPISH-së, duke rikompozuar atë në përputhje të plotë me normat statutoare dhe përfaqësimin sindikal.
- 5- Riorganizimin e strukturave organizative të FSPISH-së, sipas Statutit të FSPISH-së dhe të KSSH-së, duke plotësuar vendet vakante të krijuara nga largimet nga sindikata, kalim në funksione drejtuese, daljet në pension, vdekje natyrore, e të tjera rrethana dhe dinamika të ngjashme.
- 6- Mbështetur në Statutin e FSPISH-së, të KSSH-së Rregulloren Elektorale, ky Kongres i Jashtëzakonshëm i FSPISH-së zgjodhi në pozicionin e zv/Sekretarit të Përgjithshëm znj. R. P., në pozicionin e Kryetarit të Financës dhe Kontrollit të Brendshëm z. M. K., në pozicionin e Koordinatorës për Rrjetin e Grave znj. A. C., në pozicionin e Koordinatorit të Rrjetit të Rinisë znj. D. H.
- 7- Mbështetur në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të KSSH-së të datës 20.06.2022 ky Kongres i Jashtëzakonshëm i FSPISH-së ngarkon Asamblenë e Përgjithshme të FSPISH-së, Sekretarin e Përgjithshëm të saj dhe Komisionet e posaçme të Gjyqimit Disiplinor dhe Statutit dhe Komisionin e Financës dhe Kontrollit të Brendshëm, të miratuar nga ky Kongres, që në bashkëpunim me strukturat analoge të KSSH-së të kryejnë të gjitha procedurat statutoare dhe ligjore me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë organet ligj-zbatuese nëse konstatohet përgjegjësi penale, Degën e Tatim-Taksave, Bankën Kombëtare Tregtare, Dega 1, Tiranë punëdhënësit dhe do institucion apo strukturë tjetër që ka lidhje direkte apo indirekte me FSPISH-në, duke kthyer në normalitet gjithë aktivitetin sindikal të Federatës, si dhe duke zbatuar Statutin e FSPISH-së dhe të KSSH-së për sigurimin e transparencës në përdorimin e fondeve financiare të FSPISH-së.

- Në datën 16.01.2023 Presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë KSSH z. N. i është drejtuar OSHEE Group me një kërkesë për ri nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës. Bashkëlidhur me këtë kërkesë janë edhe vendimi me Nr.16 i datë 12.12.2022 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë “Për Depozitimin në Regjistrin e Sindikatës” të vendimit dt. 24.06.2022 të Presidencës Ekzekutive të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe vendimi Nr. 19 i dt 29.12.2022 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë “Për Depozitimin në Regjistrin e Sindikatës” të vendimit dt. 20.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).
- Në datën 18.01.2023 Departamenti i Burimeve Njerëzore i OSHEE Group me anë të një email i është drejtuar Departamentit për Çështje Ligjore të OSHEE për një koment në lidhje me shkresën Nr.593 prot., datë 16.01.2023 (protokolluar në OSHEE me Nr.419 prot., datë 17.01.2023) kontratën kolektive.
- Me shkresën nr. 1282 prot., datë 16.02.2023 Drejtoria Ligjore i është drejtuar Departamentit të Burimeve Njerëzore “Mbi kërkesën për nënshkrimin e kontratës kolektive”. Në këtë shkresë Drejtoria Ligjore pasi ka analizuar të gjithë dokumentacionin e vendosur në dispozicion dhe pasi ka tërhequr nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë vendimi Nr. 19 i dt. 29.12.2022 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë “Për Depozitimin në Regjistrin e Sindikatës” të vendimit dt. 20.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 01.02.2023 i sugjeron DBNj: *“Të shikohet mundësia që kontrata kolektive të nënshkruhet për një periudhë tranzitore disamujore nga përfaqësuesi i Konfederatës së Sindikatave, me qëllim që të “ruhet” statusi i disa të drejtave të fituara nga punonjësit nëpërmjet kontratës kolektive të mëparshme”*.
- Me shkresën nr. 611 prot., datë 06.03.2023 protokolluar në OSHEE me nr. 1952 prot., datë 10.03.2023 z. N. Presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë KSSH dhe z. K.I. Sekretari i Përgjithshëm i FSPISH i është drejtuar OSHEE Group dhe shoqërive bija (OSSH, FSHU dhe FTL) me kërkesën për ri-nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës. Kjo kërkesë vjen pas kërkesës me shkresë Nr. 593 prot., datë 16.01.2023 për të cilën nuk është marrë asnjë përgjigje në mënyrë institucionale, duke përsëritur edhe njëherë kërkesën për vazhdimin e procedurës së nënshkrimit të Kontratës Kolektive të Punës në të tre kompanitë e OSHEE Group sh.a. Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë edhe 2 vendimet e formës së prerë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi 14 dt. 27.10.2022 dhe vendimi 19 dt. 29.12.2022.
- Me shkresën nr. 4562/2 prot., datë 25.06.2024 OSHEE Group sh.a. i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Mbi kërkesën për lidhje kontrate kolektive”. Në këtë kërkesë OSHEE informon Inspektoriatin se me shkresën nr.54 prot., datë 30.05.2024 ka marrë dijeni për kërkesën e z. K. për ndërhyrjen nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore lidhur me kontratën kolektive të punonjësve të OSHEE Group sh.a. dhe shoqërive FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe FTL sh.a. OSHEE me anë të kësaj shkrese informon Inspektoriatin se z. K. nga vendimet e gjykatës së Rrethit Tiranë të vendosura në dispozicion nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë nuk është më Sekretar për Federatën e Sindikatës të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë. Gjithashtu dhe Sekretari i FSPISH i zgjedhur z. I. nuk ka vendosur në dispozicion vendim gjykatë të formës së prerë për regjistrimin e tij. Në këto kushte OSHEE konsideron shqetësuese pamundësinë e lidhjes së një kontrate kolektive me FSPISH-në, të ardhur si pasojë e konflikteve gjyqësore ndërmjet tyre.

Në këto rrethanë është kërkuar nga Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore sugjerim për një zgjidhje të mundshme të kësaj problematike.

- Me shkresën Nr. 2755/2 prot., datë 03.07.2024 Kryeinspektori Rajonal i ka kthyer përgjigje OSHEE Group sh.a. dhe z. K. dhe për dijeni Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Kryeinspektori Rajonal informon palët se pasi të jetë marrë gjithë informacioni i nevojshëm Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Tiranë, Rajoni 1, do të njoftojë të dyja palët në një takim të përbashkët. Njoftimi për ditën dhe orën e takimit do të bëhet me shkresë.

- Me shkresën Nr.633 prot., datë 13.07.2023 z. N. Presidenti i KSSH ka bërë kërkesë për takim pune me Drejtorin e Përgjithshëm të OSHEE Group.
- Me shkresën Nr.2755/4 prot., datë 30.07.2024 Kryeinspektori Rajonal i është drejtuar OSHEE Group sh.a. dhe z. K. për dijeni Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore duke i njoftuar për takim ditën e enjte, datë 01.08.2024, ora 10:00 në zyrën e Kryeinspektorit Rajonal. (Nuk ka një procesverbal për takimin e zhvilluar).
- Me shkresën Nr. 743 prot., datë 21.08.2024 z. N. Presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të OSHEE Group për takim pune.
- Me shkresën Nr. 7334 prot., datë 02.09.2024 protokolluar në OSHEE Group sh.a. me Nr. 2755/5 prot., datë 02.09.2024 Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së, Tiranë Rajoni 1 ka Autorizuar Inspektimi për subjektin Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me nipt L81530018E.
- Në datën 10.09.2024 është mbajtur procesverbal inspektimi nga Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni 1 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- Me shkresën Nr.751 prot., datë 01.10.2024 protokolluar në OSHEE Group sh.a. me Nr. 8254 prot., datë 02.10.2024 z. I., Sekretari i Përgjithshëm i Federatave të Sindikatave të Industrisë së Shqipërisë (anëtare e KSSH-së) i drejtohet OSHEE Group sh.a. duke i vënë në dispozicion gjendjen gjyqësore të FSPISH-së, aktuale.

Në këtë shkresë z.I. informon OSHEE Group sh.a. se FSPISH në datën 07.09.2024 ka mbajtur Kongresin e 6 të Zakonshëm duke mbyllur veprimtarinë dhe aktivitetin e një mandate 5 vjeçar dhe duke përcaktuar objektivat dhe zgjedhur e legjitimuar strukturat e saj drejtuese për 5 vitet e ardhshme. Dokumentacioni i plotë është depozituar sipas ligjit në fuqi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për tu regjistruar në Regjistrin e Sindikatave (OJF-ve). Pranë kësaj gjykate është duke u shqyrtuar kërkesa Nr. 1114 Akti, me kërkesë: “Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, anëtare e KSSH-së dhe pjesë e Strukturës organizative të saj, në Regjistrin e Sindikatave (OJF-ve).

- Me shkresën Nr.754 prot., datë 01.10.2024 protokolluar në OSHEE Group me Nr.8255 prot., datë 02.10.2024 z. I., Sekretari i Përgjithshëm i Federatave të Sindikatave të Industrisë së Shqipërisë (anëtare e KSSH-së) i drejtohet OSHEE Group sh.a. me kërkesë për vazhdimin e procedurave për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës kolektive të punës OSHEE Group-FSPISH.

**Për sa më sipër:** Pas verifikimit të dokumentacionit të vendosur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore si drejtoria që ndiqte zbatimin e kontratës kolektive të OSHEE Group me FSPISH dhe dokumentacionit të vendosur nga Drejtoria Ligjore konstatoi:

Mosmarrëveshjet ligjor që Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë Shqipëri (FSPISH) me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), janë bërë pengesë për lidhjen e kontratës kolektive për punonjësit e OSHEE Group.

Mungesa e një kontratë kolektive që nga data 1 Nëntori 2023 ditë kur ka përfunduar kontrata që OSHEE Group ka pasur me FSPISH ka bërë që punonjësit e OSHEE Group të humbasin disa të drejta të fituara në kontratën kolektive të mëparshme.

Nga kjo situatë e krijuar midis FSPISH dhe KSSH janë dëmtuar punonjësit e OSHEE Group që janë pjesë e FSPISH pasi OSHEE Group nuk ka një kontratë kolektive aktive në mospërputhje me Kodin e Punës.

Në këto kushte duke u mbështetur në Kodin e Punës dhe në mbrojtjen e interesave të ligjshme të punonjësve të OSHEE Group, OSHEE Group ka për detyrim lidhjen e kontratës kolektive sa më shpejt me sindikatë/a që janë krijuar dhe funksionojnë sipas legjislacionit Shqipëtar dhe nuk kanë pengesa ligjore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë Nr. 1076/4, datë 23.01.2025 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, nga z. E. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Sikundër jeni në dijeni nga procesi i auditimit situata “komplekse” e organizimit sindikal brenda “OSHEE GROUP” sh.a., si dhe në tre shoqëritë e ashtuquajtura “bija”, nuk ka ardhur si pasojë e problemeve që kanë lindur brenda grupit, por si pasojë e konflikteve që ka vetë FSPISH (Federata) me KSSH (Konfederatën).*

*OSHEE GROUP sh.a. e ka konsideruar shqetësuese pamundësinë e lidhjes së një kontrate kolektive me Federatën Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH), të ardhur si pasojë e konflikteve gjyqësore ndërmjet tyre.*

*Për këtë arsye, shoqëria i është drejtuar për zgjidhje edhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në cilësinë e institucionit përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore të legjislacionit të punës.*

*Me përfundimin e inspektimit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nga vendimi NR. ISHPSHSH - TR-2024 -003865-5 i datës 25.09.2024, nuk rezulton të ketë asnjë dënim administrativ apo plotësues për shoqërinë OSHEE GROUP sh.a.*

*Sjellim në vëmendjen tuaj se, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është duke u zhvilluar një proces ndërmjetësimi, midis shoqërisë OSHEE GROUP sh.a. dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), me objekt lidhjen e kontratës kolektive.*

*Janë zhvilluar 2 takime pranë kësaj Ministre nga Zyra Kombëtare e Pajtimet, ku është diskutuar për zgjidhjen e problematikës për lidhjen e kontratës kolektive. Aktualisht, jemi në pritje të rekomandimit nga ana e tyre.*

*Në vijim rekomandimi së bashku me korrespondencat e mëparshme do t'i përcillet edhe Grupit Negociator të Punëmarrësve për të vijuar me bisedimet për lidhjen e kontratës Kolektive me grupin sindikal të rekomanduar nga Zyra e Pajtimet Kombëtar.*

*Në datën 20.01.2025 nëpërmjet e-mail na është bërë me dije nga Zyra e Pajtimet Kombëtar rekomandimi i tyre siç është cituar “ rekomandojmë që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike - OSHEE GROUP SH.A, të vazhdojë bisedimet me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës, duke iu referuar edhe precedentëve*

*të ngjashëm”. Nga ky moment do të vijojmë me negocimin nëpërmjet Grupit Negociator të Punëmarrësve.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit kërkon nga OSHEE Group lidhjen e kontratës kolektive sa më shpejt me sindikatë/a që janë krijuar dhe funksionojnë sipas legjislacionit shqiptar dhe nuk kanë pengesa ligjore.

## **IV. REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në procesin e verifikimit të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare të shoqërive OSHEE, KESH dhe OST u konstatua mosaprovimi i pasqyrave financiare në afatet ligjore nga Këshillat Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, të shoqërive OSHEE dhe KESH, gjë e cila vështirëson procesin e konsolidimit të detyrimeve. Vonesat në aprovimin e pasqyrave financiare janë në kundërshtim me ligjin nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1, dhe me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, 46.

-Në marrëdhëniet mes palëve, përfaqësuesit juridik të shoqërive nuk kanë kryer verifikime e vlerësime të detyrimeve të ndërsjella pas vitit 2021, për shqyrtimin e situatës dhe marrjen e masave korigjuese. OSHEE me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.2 miliardë lekë. Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore të ndarjes shoqërive dhe penaltite të ndryshme midis palëve. OST me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 1.5 miliardë lekë. Kjo diferencë përbëhet nga faturat të papranuara nga OST, që janë penaltite për moslikujtime në afat, të energjisë elektrike të ofruar për disbalancat, aktivizime rezerve dhe shërbime të tjera. OSHEE në marrëdhëniet me OST, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.3 miliardë lekë, e cila përbëhet nga faturime të OST-së ndaj OSHEE-së në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, vlerë e ankimuar në gjykatë. Mosdakordësitë që shoqëritë e sistemit energjetik kanë mes tyre për llogaritë përkatëse debitore pengojnë procesin e konsolidimit të detyrimeve të mbartura dhe kompensimin/shuarjen e tyre. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 74. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 1, faqe 13 të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Organet drejtuese të KESH dhe OSHEE të marrin masa për aprovimin e pasqyrave financiare të periudhave të kaluara dhe depozitimin e tyre në Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke mundur konsolidimin/vlerësimin e gjendjes financiare dhe performancës ekonomike të shoqërive nga palët e tjera të interesit.

Përfaqësuesit juridikë të shoqërive duhet të kryejnë procesin e verifikimit dhe vlerësimit të detyrimeve të ndërsjella dhe të marrin masa për zgjidhjen e mos marrëveshjeve të llogarive debitore në rrugë gjyqësore të përsheptuara duke pasqyruar vendimet përfundimtare në pasqyrat financiare ose nëpërmjet miratimit/njohjes nga asambleja e ortakëve duke u ndodhur në rastin që është e njëjta për shoqëritë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Reforma e sektorit të energjisë ka pasur si synim të saj përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe arritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria financiare e sistemit energjetik në Shqipëri varet nga shumë faktorë, por qarkullimi i likuiditeteve ndërmjet shoqërive OSHEE, KESH, OST, si dhe kryerja në kohë e pagesave të përdoruesve fundorë, privatë apo publikë është thelbësore. Moskorrektësia e pagesave ndërmjet shoqërive në sistem ka sjellë vështirësi në shlyerjen e furnitorëve, akumulimin e penaliteteve e shoqëruar me faturat përkatëse, duke sjellë rritje të detyrimeve, mosmarrëveshje mes palëve dhe jo dakordësi për situatën financiare dhe përkeqësim të saj të pajustificuara.

Detyrimet e akumuluar ndërmjet vite në shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike, kanë ndikuar negativisht në të gjithë sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht në aktivitetin ekonomik të secilës shoqërie pjesëmarrëse në këtë sektor. Pasojat kanë qenë të shumta, si rritja e kostove të shërbimit, mungesë e realizimit të investimeve në nivelin e duhur, uljen e aftësisë paguese të tyre, marrjen e huave për mbulimin e shpenzimeve, duke përkeqësuar kështu performancën e tyre.

Performanca e ulur e sistemit energjetik është e lidhur dhe me situatën tjetër si emergjenca botërore e rritjes së çmimeve, kushtet klimaterike të thata, të cilat kanë bërë që energjia të importohet me çmime më të larta se sa prodhimi në vend, duke ndikuar në rritjen e kostos së shërbimit, gjë e cila reflektohet në shoqërinë KESH, e cila ka detyrimin për furnizimin e energjisë në sistem.

Detyrimet e prapambetura për energji elektrike nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujit, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura dhe parashikueshmëria e të ardhurave janë penguar, duke krijuar vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit. Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2, faqe 19 të Raportit të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Organet drejtuese të shoqërive të sistemit energjetik, OSHEE, KESH dhe OST, të marrin masa për propozim për marrëveshje kompensimi/shuarje te Ministria e Financës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, duke pasqyruar situatën aktuale të detyrimeve të ndërsjella në sektor. Në marrëdhënien mes tre shoqërive duhen vlerësuar dhe mundësitë e pagesave nga Buxheti i Shtetit të këtyre detyrimeve por me garancinë që do të qarkullojnë në të gjitha shoqëritë e sistemit energjetik për të realizuar mbylljen e detyrimeve. Organet drejtuese të shoqërive të sistemit energjetik e kanë të nevojshme të konsolidojnë pozicionet financiare për mos rakordimet mes palëve, të ndalojnë akumulimin e detyrimeve të ndërsjella, bazuar në objektivitet dhe mirëkuptim.

**2.2 Rekomandimi:** Ministria e Financës ose Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës të marrin përsipër të kryejnë pagesa për detyrimet për energji elektrike të institucioneve buxhetore dhe ujësjellësve duke u garantuar që këto pagesa kalojnë nga FSHU te OSSH ose OSHEE e cila mbyll detyrimin që ka ndaj KESH dhe OST.

**2.3 Rekomandimi:** Organet drejtuese të OSHEE-së, FSHU-së dhe OSSH-së të marrin masa për krijimin e mekanizmave të monitorimit të performancës në sistemin e shpërndarjes dhe faturimit dhe mbledhjes së pagesave në sektorët problematikë (institucionet buxhetore dhe ujësjellësit), aplikimin e politikave të garancive dhe mekanizmave të brendshëm për të siguruar pagesën nga entet buxhetore të detyrimeve për furnizim me energji elektrike.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit është depozituar ankesa me nr.1144 port., datë 23.09.2024 e bërë nga z. T.K., Sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH) në lidhje me mos rinovimin e kontratës kolektive të OSHEE me Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FSPISH).

Grupi i auditimit pasi verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore si drejtoria që ndiqte zbatimin e kontratës kolektive të OSHEE-së me FSPISH dhe dokumentacionit të vendosur nga Drejtoria Ligjore konstatoi se mosmarrëveshjet ligjore që Federata e Sindikatave të Punonjësve të Industrisë Shqipëri (FSPISH) ka pasur me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), janë bërë pengesë për lidhjen e kontratës kolektive për punonjësit e OSHEE-së.

Nga kjo situatë e krijuar midis FSPISH dhe KSSH janë dëmtuar punonjësit e OSHEE-së që janë pjesë e FSPISH-së, pasi OSHEE nuk ka një kontratë kolektive aktive, veprime në mos përputhje me Kodin e Punës, nenet 159-179. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 4, faqe 44 të Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Organet drejtuese të OSHEE-së të marrin masa që duke u mbështetur në Kodin e Punës dhe në mbrojtjen e interesave të ligjshme të punonjësve të OSHEE-së, për lidhjen e kontratës kolektive sa më shpejt me sindikatë/a që janë krijuar dhe funksionojnë sipas legjislacionit Shqiptar dhe nuk kanë pengesa ligjore.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes disa marrëveshjeve ristrukturimi afatgjatë mes kompanive. Më datë 03.12.2020, OSHEE ka bërë marrëveshjet me shoqëritë OSSH, FSHU dhe FTL, për transferimin e aktivitetit, aseteve dhe detyrimeve përkatëse. OSSH merr përsipër të paguajë vlerën 27,743,259,674 lekë për detyrimin ndaj KESH, vlerën 7,147,410,828 lekë për detyrimin ndaj OST dhe vlerën 6,103,459,597 lekë për kredinë afatshkurtër dhe vlerën 10,137,199,278 lekë për kredinë afatgjatë. Shoqëria FTL, ka marrë përsipër të paguajë vlerën 70,292,688 lekë për detyrimin ndaj KESH dhe vlerën 11,422,600 lekë për detyrimin ndaj OST-së. Shoqëria FSHU ka marrë përsipër të shlyejë vlerën 16,551,885,350 lekë për detyrimin ndaj KESH dhe 2,689,690,425 lekë për detyrimin ndaj OST-së.

OSSHE e cila ka barrën e pagesave ndaj KESH dhe OST, nuk ka bërë një plan pagesash (skedul) për ndarjen me këste të detyrimeve që kompanitë OSSH, FSHU dhe FTL do duhet t'ia paguajnë duke mundësuar dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it dhe OST-së. Mospasja e një marrëveshje për ndarjen me këste të detyrimit përkatës që secila kompani ka ndaj KESH-it dhe OST-së ka ndikuar në mospagesën e këtyre detyrimeve të plota dhe në kohë. Për marrëveshjet që OSHEE ka ndaj KESH-it dhe OST, pagesat janë kryer vetëm nga shoqëria OSSH por edhe ato pagesa që janë bërë janë jo të plota dhe në mospërputhje me detyrimin e përcaktuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2, faqe 19 të Raportit të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Organet drejtuese të shoqërive OSHEE, OSSH, FSHU dhe FTL, në lidhje me detyrimin që OSHEE ka ndaj KESH-it dhe OST-së, dhe që është i përcaktuar në pasqyrat financiare të shoqërive bija, duhet të dakordësojnë afatet e pagesave mujore ose tremujore në mënyrë që marrëveshja kryesore të zbatohet dhe situata debitore të përmirësohet.

Zvogëlimi llogarive kreditore të KESH dhe OST nga OSHEE, do të përmirësonte situatën respektive financiare dhe do të mundësonte investime të mëtejshme për të rritur performancën, likuidimin e detyrimeve përkatëse ndaj bankave në afat dhe shmangien e penaliteteve.

**C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** OSHEE ka detyrim ndaj KESH-it në vlerën prej 51,438,460,429 lekë, nga të cilat 40,853,480,443 lekë për fatura shitjeje energjie elektrike dhe 10,584,979,986 lekë penalitete. Për këtë detyrim shoqëritë në vitin 2018 kanë lidhur Marrëveshjen për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, marrëveshje e amenduar në vitin 2021. Nga kështet e pagesave të OSHEE, një pjesë është për të shlyer Huan e Ristrukturimit të KESH-it ndaj BERZH-it.

Pas amendimit të marrëveshjes, KESH i është drejtuar shoqërive FSHU dhe OSHEE për shlyerjen e detyrimeve financiare, duke vendosur si afat datën 21.01.2022. Për periudhën 2021-2024, detyrimi i OSHEE ndaj KESH ishte 9,001,428,962 lekë, nga këto janë shlyer vetëm 2,000,000,000 lekë dhe diferenca e papaguar është 7,001,428,962 lekë.

Vështirësia financiare dhe mungesa e theksuar e likuiditeteve ka detyruar KESH t'i kërkojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbështetje buxhetore me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbimin publik të ngarkuar, mbështetje e alokuar për shoqërinë nga MFE nëpërmjet Huasë Buxhetore në vlerën totale 68 milionë euro, në vitin 2022.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, konkretisht neni 3, pika 3, në buxhetin e vitit 2022 është shtuar *“Fondi prej 20,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik ...”*.

Pavarësisht marrëveshjes dhe amendimit për periudhën 2021-2023, OSHEE nuk ka realizuar grafikun e pagesave ndaj KESH dhe nuk ka dhënë sqarime për shkaqet e mospagesave.

Mosplotësimi i detyrimeve nga OSHEE ndaj KESH, si dhe situata emergjente ka detyruar Buxhetin e Shtetit të akordojë ndaj KESH kredinë 68 milionë euro si dhe shtesë në kapital 20 miliardë lekë.

Sigurimi i fondeve shtesë në Buxhetin e Shtetit në këtë periudhë është realizuar duke rritur borxhin e brendshëm dhe, duke ju referuar të dhënave të buletinit të Ministrisë së Financave, kosto mesatare e borxhit të brendshëm për vitet 2022-2024, nuk ka qenë asnjëherë më poshtë se 4 %.

Kosto financiare e likuiditeteve që OSHEE i detyrohej KESH-it për të paguar, por që u plotësua nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet instrumenteve të borxhit të brendshëm është në vlerën 635,196,774 lekë. Mosveprimet nga OSHEE për shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it për periudhën 2022-2024, kanë sjellë shpenzime pa efikasitet nga Buxheti i Shtetit, në vlerën 635,196,774 lekë. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2, faqe 19 të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Organet drejtuese të OSHEE-së, Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionerëve të shqyrtojnë vlerën 635,196,774 lekë e cila përbën shpenzime pa efikasitet për Buxhetin e Shtetit dhe të marrin masa që në programin ekonomik të OSHEE-së të planifikohet dhe zbatohet likuidimi i kësteve të marrëveshjes që ka lidhur me KESH.